

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**RAPORT VJETOR MBI VEPRIMTARINË E
DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS
PËR VITIN 2020**

Përmbajtja

Hyrje	4
KAPITULLI 1: KUADRI LIGJOR	6
- Miratimi i 2 akteve të fundit nënligjore në zbatim të Ligjit nr.111/2017.....	6
- Miratimi i Rregullores së Brendshme të DNJF.....	7
- Miratimi i propozimeve për ndryshim në shtojcën nr.1 dhe 2 të Urdhrit Urdhrit nr.226, datë 25.3.2019.....	8
KAPITULLI 2: STRUKTURA DHE ORGANIKA	9
- Plotësimi i stafit të DNJF.....	9
- Qendrat me buxhetin e shtetit / OSFA / UNDP.....	10
KAPITULLI 3: NDIHMA JURIDIKE PARËSORE	11
- Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.....	11
- Ofrimi i ndihmës juridike nga OJF-të e autorizuar.....	14
- Ofrimi i ndihmës juridike nga Klinikat e ligjit.....	17
- Ofrimi i ndihmës juridike online.....	18
- Ofrimi i ndihmës juridike përmes numrit të gjelbër.....	19
- Administrimi i të dhënave të ofruesve të shërbimit.....	19
KAPITULLI 4: NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE	21
- Bashkëpunimi me avokatët e ndihmës juridike dytësore.....	21
- Administrimi i të dhënave të ndihmës juridike dytësore.....	25
- Ndjekja e vendimeve gjyqësore me objekt ndihmën juridike.....	26
KAPITULLI 5: VLERËSIMI I CILËSISË SË SHËRBIMIT	29
- Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Qendrat e shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.....	30
- Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Avokatët ofrues të ndihmës Juridike dytësore.....	31
- Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar përmes platformës juristonline.....	31
KAPITULLI 6: FORCIMI I KAPACITETEVE TË STAFIT TË DNJF DHE OFRUESVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE	32
- Forcimi i kapaciteteve të stafit të DNJF.....	32
- Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	32
- Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.....	34
KAPITULLI 7: BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE EURALIUS, UNDP DHE OSFA	36
- Bashkëpunimi me Euralius V.....	36

- Bashkëpunimi me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.....	38
- Bashkëpunimi me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.....	39
KAPITULLI 8: BASHKËPUNIMI ME AKTORË TË TJERË TË SISTEMIT	
TË DREJTËSISË.....	41
- Nënshkrimi i Marrëveshjeve të Mirëkuptimit me Gjykatat.....	41
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me OJF e autorizuar ALTRI.....	42
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me organizatën Drejtësia Sociale.....	43
KAPITULLI 9: AKTIVITETE NDËRGJEGJËSUESE.....	44
- Zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të forcimit të sistemit të ndihmës juridike parësore.....	44
- Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit.....	50
KAPITULLI 10: ANGAZHIMET STRATEGJIKE TË DNJF.....	52
- Angazhim i DNJF në kuadër të SELP.....	52
- Angazhim i DNJF në kuadër të SND.....	55
- Angazhim i DNJF në kuadër të SNKK.....	55
- Angazhim i DNJF në kuadër të SDM.....	56
- Angazhim i DNJF në kuadër të PKVIRE.....	56
KAPITULLI 11: ANGAZHIMET E DNJF NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN DHE RAPORTIME NDËRKOMBËTARE.....	57
- Raportime në kuadër të procesit të Integrimit Evropian.....	57
- Raportime ndërkombëtare.....	57
- Kontribut në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit IPA.....	58
KAPITULLI 12: PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021.....	61
KAPITULLI 13: ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA.....	62

Bashkëlidhur këtij raporti:

- **Shtojcë nr.1:** Raport Përmbledhës vjetor mbi monitorimin të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore;
- **Shtojcë nr.2:** Analizë statistikore për ndihmën juridike parësore dhe dytësore 2020.

HYRJE

Ndihma juridike e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që çdo shtet duhet ta garantojë në mënyrë efçente dhe efektive.

Ligji nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të garantuar nga shteti”, është një ndër ligjet e miratuara në kuadër të reformës në drejtësi, hyrja e në fuqi e të cilit solli një reformim të thellë të sistemit të ndihmës juridike duke sjellë një frymë të re sa i përket organizimit, funksionimit dhe ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Qëllimi kryesor i këtij ligji është dhënia e ndihmës juridike falas për të gjitha kategoritë, të cilat për shkak të kushteve në të cilat ndodhen e kanë të pamundur sigurimin e këtij shërbimi. I është kushtuar një vëmëndje e veçantë kategorive përfituese duke patur në fokus zgjerimin e rrethit të subjekteve si dhe sanksionimin e grupeve vulnerbalël si përfitues të drejtëpërdrejtë nga sistemi i ndihmës juridike falas.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas¹ është institucioni i dedikuar në çështjet e ndihmës juridike, përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në varësi të Ministrisë të Drejtësisë.

Në funksion të transparencës dhe llogaridhënies si dhe në zbatim të nenit 8 shkronja “dh” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ku përcaktohet se “DNJF harton raportet vjetore për veprimtarinë e saj në lidhje me zbatimin e këtij ligji dhe të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrisë të Drejtësisë”, ky raport paraqet një panoramë analitike të veprimtarisë së DNJF për vitin 2020, sipas objektivave të përcaktuara në planet gjashtë mujore të punës dhe konkretisht:

- 1. Forcimi i sistemit të ndihmës juridike parësore;*
- 2. Forcimi i sistemit të ndihmës juridike dytësore;*
- 3. Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes;*
- 4. Bashkëpunimi me donatorë dhe institucionet e përfshira në sistemin e ndihmës juridike falas;*
- 5. Rritje e angazhimit të DNJF në kuadër të dokumentave strategjike;*
- 6. Rritje e angazhimit të DNJF në kuadër të procesit të integritetit evropian;*
- 7. Promovimi i sistemit të ndihmës juridike;*
- 8. Forcimi i kapaciteteve të stafit të DNJF / ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike;*
- 9. Raportime mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti;*
- 10. Menaxhimi dhe planifikimi financiar i sistemit të ndihmës juridike.*

Këto objektiva janë bazuar në:

- Prioritetet e vendosura nga Ministria e Drejtësisë;*
- Rekomandimet e përcjella nga Raportet Ndërkombëtare;*

¹ Në vijim DNJF.

- *Angazhimet strategjike të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas;*
- *Rekomandimet e përcjella nga Institucionet e pavarura;*
- *Rekomandimet e përcjella nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*

Sa më sipër, mund të themi se përgjatë vitit që lamë pas, pavarësisht sfidave dhe vështirësive të hasura si pasojë e pandemisë Covid-19, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka përmbushur të gjitha objektivat e sipërpërmendura duke garantuar kështu funksionimin me efikasitet dhe cilësi të të gjithë sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Përmes këtij publikimi Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas shpreh falënderime për të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti si dhe të gjithë bashkëpunëtorët që na kanë mbështetur duke bërë të mundur kështu përmbushjen e të gjitha objektivave të përcaktuara për vitin 2020.

Kapitulli 1

KUADRI LIGJOR

- *Miratohen dy aktet e fundit që lidhen me tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore si dhe caktimin e tyre në bazë të parimit të rotacionit duke plotësuar kështu të gjithë kuadrin ligjor për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.*

Muaji Shtator 2020 shënon një arritje të rëndësishme sa i përket miratimit të akteve të fundit nënligjore në zbatim të ligjit nr.111/2017, duke plotësuar kështu të gjithë kuadrin ligjor në fushën e ndihmës juridike.

Tashmë, ligji nr.111/2017, është plotësuar dhe ndiqet nga 13 akte nënligjore të cilat rregullojnë në mënyrë të detajuar çdo fushë specifike të ndihmës juridike dhe kanë sjellë një serë risish e procedurash të reja, konkretisht si vijon:

- Vendim nr. 55, datë 6.2.2019, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”;
- Vendim nr. 110, datë 06.03.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”;
- Udhëzimi nr. 1 datë 06.03.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 4 datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”;
- Udhëzim nr. 1, datë 08.03.2019, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”;
- Urdhër nr. 225 datë 25.03.2019, i Ministrisë së Drejtësisë, “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”;
- Urdhër nr. 226, datë 25.03.2019, i Ministrisë së Drejtësisë, “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti” ndryshuar me Urdhrin nr. 424 datë 18.12.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, “Për disa shtesa në urdhrin nr. 226, datë 25.03.2019” si dhe Urdhrin nr. 447, datë 31.12.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 226, datë 25.03.2019”;
- Urdhër i Kryeministrit nr 59, datë 25.3.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së drejtorisë së ndihmës juridike falas”;
- Udhëzimi nr. 6 datë 20.08.2019, “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore për të cilat është vendosur përjashtimi në rastin e dhënies së ndihmës juridike”;

- Udhëzimi nr. 2 datë 25.03.2019, “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”;
- Vendim nr. 231, datë 12.11.2019, “Për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal”;
- Urdhër nr. 531, datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”;
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 5.8.2020, "Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”;
- Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë nr. 17 datë 05.08.2020, “Për rregullat e zbatimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative”.
- **Miratohet Rregullorja e Brendshme “Për Organizimin dhe Funksonimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”.**

Gjthashtu, në funksion të përcaktimit të rregullave lidhur me organizimin, funksionimin dhe administrimin e DNJF, me Urdhër nr. 393 datë 23.11.2020, të Ministrit të Drejtësisë është miratuar Rregullorja e Brendshme “Për Organizimin dhe Funksonimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”.

Në mënyrë të përmbledhur, Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksonimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas përcakton rregulla lidhur me organizimin, funksionimin dhe administrimin e DNJF, duke u ndalur kryesisht në:

- a) Rregullimin e mënyrës së organizimit të DNJF, sipas strukturave;
- b) Përshkrimin e detyrave funksionale dhe kompetencave të nëpunësve dhe punonjësve administrativë sipas hierarkisë;
- c) Bashkërendimin e punës së strukturave të brendshme të Drejtorisë me institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike, si edhe publikun, medien dhe çdo subjekt tjetër të interesuar;
- d) Caktimin e rregullave të përgjithshme të etikës, mbarëvajtjes, disiplinës në marrëdhëniet e punës etj.

- ***Miratohen propozimet për ndryshime në Urdhrin nr. 226 datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kontratave të ofruesve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.***

Nisur nga 2 problematika kryesore që kanë rezultuar nga zbatimi në praktikë i detyrave funksionale të DNJF të cilat konsistojnë konkretisht:

- ***Mënyra e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara (në kushtet kur kontrata e financimit e të OJF-ve e miratuar me udhën e sipërcituar të Ministrit të Drejtësisë nuk parashikon rregullat dhe procedurat mbi mënyrën e financimit për OJF e autorizuara);***
- ***Përfshirja e metodologjisë së vlerësimit të cilësisë së shërbimit të ofruar në kontratat tip të avokatëve për ofrimin e ndihmës juridike dytësore (Në kushtet kur kontratat e avokatëve të miratuara me këtë urdhër nuk përmbanin parashikim lidhur me zbatimin e standardeve të përcaktuara në urdhrin nr. 531, datë 25.11.2019 “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”;***

DNJF ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë propozimet përkatëse për shtesa dhe ndryshime në Urdhrin e sipërcituar. Këto propozime janë miratuar nga ana e Ministrit të Drejtësisë përkatësisht me Urdhrin nr. 424 datë 18.12.2020, , “Për disa shtesa në urdhrin nr. 226, datë 25.03.2019” si dhe Urdhrin nr. 447, datë 31.12.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 226, datë 25.03.2019”.

Kapitulli 2

STRUKTURA DHE ORGANIKA

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, është person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, organizimi i brendshëm i së cilës është miratuar nga Kryeministri me Urdhër Nr. 59, datë 25.03.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë Ndhmës Juridike Falas”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bazuar në strukturën e miratuar nga Kryeministri², Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, ka në përbërje të saj drejtoritë e mëposhtme:

- Drejtori i Përgjithshëm;
- Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore;
- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike;
- Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- 8 (tetë punonjës) të angazhuar pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.

Që prej Nëntorit të vitit 2019, DNJF ka funksionuar me një staf të reduktuar prej 11 specialistësh, njëri prej të cilëve në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të komanduar të Drejtorisë.

Me qëllim që struktura të plotësohej me stafin e saj drejtues: (*Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas; Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore; Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike; Drejtori i Drejtorisë së Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse*), ka vijuar në mënyrë të përsëritur me komunikimet me Departamentin e Administratës Publike me qëllim shpalljen e vendeve vakante dhe përfundimin e procedurave të rekrutimit.

Me Urdhër nr. 201, datë 01.7.2020, të Ministrit të Drejtësisë është emëruar Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas (TND). Gjithashtu, me Urdhër nr. 529 prot. Datë 11.11.2010, është emëruar Drejtori i Drejtorisë së Administrimit të Politikave të Ndhmës Juridike Parësore.

Për dy Drejtorët e Drejtorive të Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike dhe Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse, në kushtet kur pozicionet vakante janë shpallur disa herë dhe procedurat kanë përfunduar pa fitues, DAP ka vijuar me rishpalljen e

² <https://www.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2019/04/Urdher-nr.59-date-25.03.2019-Per-miratimin-e-strukture-dhe-te-organikes-se-Drejtorise-se-Ndihmes-Juridike-Falas.pdf>

vendeve vakante në muajin Dhjetor 2020, dhe pritet që brenda muajit Shkurt 2020 të përfundohet procedura e rekrutimit³.

Sa i përket qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, referuar strukturës organizative të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas miratuar me Urdhërin Nr. 59, datë 25.03.2019, të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë Ndihmës Juridike Falas*”, janë pjesë e strukturës të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas 8 (tetë) punonjës me trajnim të posaçëm.

Ashtu siç do të parashtrohet më në detaje në kapitullin nr. 3, DNJF aktualisht administron 1 qendër të shërbimit të ndihmës juridike parësore, pjesë të strukturës së saj e cila mbështetet me buxhetin e shtetit. Konkretisht, qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në Lushnje.

6 (gjashtë) qendrat e tjera që DNJF administron, janë hapur me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtare si OSFA dhe UNDP dhe rrjedhimisht , punonjësit e angazhuar pranë këtyre qendrave nuk janë pjesë e strukturës organike të DNJF⁴.

³ <http://dap.gov.al/vende-vakante/shpallje/drejtues>

⁴<https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2019/04/Urdher-nr.59-date-25.03.2019-Per-miratimin-e-struktures-dhe-te-organikes-se-Drejtorise-se-Ndihmes-Juridike-Falas.pdf>

Kapitulli 3

NDIHMJA JURIDIKE PARËSORE

Bazuar në nenin 13 të ligjit 111/2017, ndihma juridike parësore jepet nga:

- a) *Punonjësit me trajnim të posaçëm;*
- b) *Organizatave jofitimprurëse të autorizuar;*
- c) *Klinikat Ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.*

Administrimi dhe promovimi i sistemit të ndihmës juridike parësore ka qenë një ndër prioritet kyç të DNJF. Përgjatë këtij viti DNJF ka mbajtur një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore si dhe me organizatat ndërkombëtare partnere si UNDP; OSFA apo EURALIUS me qëllim nxitjen dhe shtritjen e sistemit të ndihmës juridike parësore.

- **Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.**

Përgjatë vitit 2020, është mundësuar hapja e të gjitha qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore të planifikuara (*objektivi fillestar është përcaktuar në 5 qendra të reja brenda vitit 2020*) dhe konkretisht: Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në **Lushnje; Pogradec; Gjirokastrë** si dhe është mundësuar rivitalizimi i Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në **Durrës; Shkodër** dhe **Lezhë** nën administrimin e DNJF, referuar marrëveshjes së nënshkruar midis Ministrisë së Drejtësisë dhe UNDP, “*Shtrirja e Shërbimeve të ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri, 2019-2022*”.

Në kuadër të kalimit nën administrim të qendrave të sipërcituara, për qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore në Durrës, Shkodër dhe Lezhë janë shpallur thirrjet për rekrutimin e punonjësve me trajnim të posaçëm në muajin Nëntor 2020, muaj gjatë të cilit kanë përfunduar procedurat e rekrutimit dhe janë publikuar kandidatët fitues⁵.

Për qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore në Fier, Dibër dhe Vlorë, do të vijohet shpallja e vendeve vakante brenda vitit 2021.

Për bërjen funksionale të këtyre qendrave janë angazhuar një sërë institucioneve përgjegjëse përmendim këtu UNDP; ADISA; Bashkitë respektive; Gjykatat e Rrethit Gjyqësor) përmes nënshkrimit të marrëveshje të bashkëpunimit të poshtëshënuara të cilat do të parashtrohen më në detaje në kapitujt në vijim:

⁵ <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/vende-vakante/>

Marrëveshja e bashkëpunimit “Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundërshpërblim” me:

1. Agjencinë e Integruar të Shërbimeve (ADISA) (Marrëveshja nr.632/1 Dt.09.12.2020)
2. Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës (Marrëveshja nr. 505/1 prot., datë 05.11.2020);
3. Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër (Marrëveshja nr. 506/1 prot., datë 05.11.2020);
4. Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër (Marrëveshja nr. 503/1 prot., datë 05.11.2020);
5. Bashkinë Pogradec (Tetor 2020);
6. Bashkinë Lushnje (Shtator 2020);
7. Bashkinë Lezhë (Marrëveshja nr. 7043/1 prot., datë 09.11.2020).

Për vitin e ardhshëm objektiv është hapja e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Elbasan, Fier; Vlorë dhe Dibër duke e çuar **numrin total të qendrave që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas administron në 11 (njëmbëdhjetë)**⁶.

Për të patur një tablo më të qartë, të dhëna specifike mbi çdo qendër janë parashtruar si vijon:

Nr.	Qendra	Mbështetës	Inaguruar/administruar më	Nr. i Punonjësve	Vendodhja
1	Tiranë	OSFA	Prill 2020	3	Ministria e Drejtësisë
2	Lushnje	Buxhetin e Shtetit	Shtator 2020	1	Pranë Bashkisë Lushnje
3	Pogradec	UNDP	Tetor 2020	2	Pranë Bashkisë Pogradec
4	Gjirokastrë	UNDP	Dhjetor 2020	2	Pranë ADISA Gjirokastrë
5	Durrës	UNDP	Dhjetor 2020	2	Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës
6	Lezhë	UNDP	Dhjetor 2020	1	Pranë Bashkisë Lezhë
7	Shkodër	UNDP	Dhjetor 2020	2	Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

⁶ Në zbatim të neneve 91 e 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Referuar këtij vendimi, për një periudhë 4 (katër) mujore përpara datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve janë të përcaktuara në mënyrë eksplicite një sërë veprimtarish/procedurash të ndaluara për t`u zhvilluar nga organet e administratës publike. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, pas analizimit të këtij akti, me shkresën me nr. 19 prot., datë 11.01.2020 vlerësoi të nevojshme dhënien e një orientimi ligjor nga ana e KQZ, nëse veprimtaritë e planifikuara për t`u zhvilluar për 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2021 (referuar planit të punës si dhe Strategjisë 5 vjeçare për ndihmën juridike të garantuar nga shteti) konsiderohen ose jo veprimtari të ndaluara dhe konkretisht: **Veprimtaria nr. 1: Hapja e Qendrave të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore; Veprimtaria nr. 2: Financimi i OJF-të e autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike. Mbetemi në pritje të dhënies së një përgjigje nga ana e këtij institucioni.**

8	Elbasan ⁷	Buxhetin e Shtetit	-	2	Papërcaktuar ⁸
9	Fier	UNDP	Papërcaktuar	Papërcaktuar	Pranë ADISA Fier
10	Vlorë	UNDP	Papërcaktuar	Papërcaktuar	Papërcaktuar
11	Dibër	UNDP	Papërcaktuar	Papërcaktuar	Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

Gjithashtu, është mundësuar zhvillimi i takimeve të punës në baza periodike me të gjithë punonjësit me trajnim të posaçëm nëpërmjet të cilave janë vendosur prioritetet dhe objektivat e përbashkët në funksion të forcimit të sistemit të ndihmës juridike parësore si dhe po mbahen komunikime ditore me këta punonjës me qëllim përmbushjen e këtyre objektivave.

Në kuadër të mbarëvajtjes së punës, punonjësit e çdo qendre respektive janë informuar në mënyrë të detajuar për detyrimet e tyre ligjore si dhe masat që duhet të ndërmerren në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike parësore dhe dhënien e një shërbimit cilësor dhe profesional nëpërmjet:

- Komunikimit ditor me stafin e DNJF;
- Zhvillimit të takimeve periodike, përmëdim këtu takimin e zhvilluar me Ministrin e Drejtësisë më datë 9 Shtator 2020⁹;

⁷ Ministria e Drejtësisë, në kuadër të projektit: “Qendrat e Ndhmës Juridike parësore në Tiranë dhe Elbasan”, ka nënshkruar një kontratë me Fondacionin Shqipëria e Hapur për Shqipërinë me qëllim ofrimin e shërbimeve ligjore nëpërmjet themelimit të dy qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Tiranë dhe Elbasan, (kontrata e grantit nr. 8331).

Në kushtet kur që prej datës 31.07.2020, kontrata e grantit përfundoi, DNJF propozoi pranë OSFA mundësinë për ripërtëritjen e kontratës së grantit por me anë të emailit datë 12.08.2020, se nga Fondacioni Shqipëria e Hapur për Shqipërinë **nuk u miratua mbështetja e Qendrës së Ndhmës Parësore në Elbasan (hapur pranë ambienteve të Bashkisë Elbasan) por vetëm i Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë.**

Në këto kushte, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, me qëllim vijimin e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytetin e Elbasanit **propozoi pranë Ministrin të Drejtësisë kalimin e kësaj qendre si pjesë e strukturës organizative të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe financimin e saj me buxhetin e Drejtorisë, propozim i cili u miratua në muajin Nëntor 2020.**

⁸Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit nr.6281prot.,datë 11.09.2019, midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Bashkisë Elbasan “Për sigurimin e zyrës së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore pranë mjediseve të Bashkisë Elbasan,pa kundërshpërblim”,vendodhja e kësaj zyre ishte parashikuar të ishte pranë ambienteve të Bashkisë Elbasan.Në vijim të komunikimeve zyrtare me Bashkinë Elbasan,kjo e fundit është zhvendosur në një ambient tjetër larg qendrës për arsye rikonstruksioni,duke bërë të pamundur sigurimin e një ambienti të përshtatshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm për qytetarët. Kjo gjë ka passjellë pamundësinë objektive të funksionimit të kësaj qendre. Tashmë, me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me ADISA, një objektiv për vitin e ardhshëm mbetet bërja funksionale e kësaj qendre pranë ambienteve të Qendrës së Integruar Adisa, Elbasan.

⁹ Pranë ambienteve të Ministrisë së Drejtësisë, me prezencën e Ministres së Drejtësisë, zj. Etilda Gjonaj u zhvillua më datë 01.09.2020, një takim pune me punonjësit me trajnim të posaçëm në Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Falas në Tiranë, Durrës, Fier dhe Lezhë. Në këtë takim ju kushtua një rëndësi e veçantë diskutimit mbi mënyrat e sensibilizimit të qytetarëve dhe nxitjen e tyre për të marrë shërbimin ligjor falas pranë këtyre qendrave.

- Zhvillimit të webinarëve nga DNJF, përmendim këtu webinarin e datës 29 Tetor 2020, “Mbi procedurën e administrimit të të dhënave dhe raportimit nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore”, me pjesëmarrjen e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara dhe Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve.¹⁰;
- Zhvillimit të trajnimeve në kuadër të rritjes së kapaciteteve të punonjësve me trajnim të posaçëm, përmendim këtu trajnimin e datës 24 Shtator 2020, me mbështetjen e UNDP¹¹;
- Zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese me aktorë të tjerë të shoqërisë civile me qëllim krijimin e një *netëork-u* të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike falas, përmendim këtu tryezën e diskutimit të organizuar më datë 13 prill 2020 në Elbasan organizuar me date 5 Mars nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas me perfaqesues nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Bashkia Elbasan, Drejtoria e Policisë Vendore dhe perfaqesues te Organizatave Jofitimprurëse¹².

Aktivitetet e kësaj natyre do të vijojnë të zhvillohen në mënyrë periodike edhe përgjatë vitit 2021, sipas një plani pune dhe kalendari aktivitetesh të dakordësuar nga DNJF dhe Ministria e Drejtësisë mbi të cilat do të flitet më në detaje në kapitullin 12 të këtij raporti.

- Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara

Referuar nenit 15 të ligjit 111/2017, Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në VKM nr. 110, datë 06.03.2019, afati, Komisioni i Drejtësisë së Ndhmës Juridike Falas ngritur me urdhër nr. 199, datë 18.06.2020, ka vijuar me shqyrtimin e detajuar të dosjeve të përcjella duke hartuar për secilin aplikim një relacion përmbledhës shoqëruar edhe me propozimin për miratimin ose jo të autorizimit nga Ministri i

¹⁰ Qëllimi kryesor i këtij webinari ishte diskutimi në terma teknikë dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit në kuadër të rasteve të trajtuara, mbajtjes të të dhënave dhe administrimit të tyre sipas formateve të reja të përcaktuara nga aktet nënligjore.

¹¹ Pranë ambienteve të Drejtësisë së Ndhmës Juridike Falas më datë 24 Shtator 2020, u zhvillua moduli i parë i trajnimit të detyrueshëm të punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore. Në këtë trajnim, punonjësit e qendrave patën mundësi të përfitojnë njohuri më të thelluara sa i përket sistemit të ndihmës juridike falas me ndryshimet që solli hyrja në fuqi e ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” duke i kushtuar një rëndësi të veçantë kuadrin ligjor specifik për kategoritë e veçanta përfituese të shërbimit të ndihmës juridike (përmendim këtu kuadrin ligjor mbi mbrojtjen e viktimave të dhunës, abuzimit seksual dhe trafikimit; të miturve në konflikt me ligjin; personave që përfitojnë ndihmë ekonomike si dhe personave të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim). Ky trajnim u realizua me mbështetjen e UNDP në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe UNDP në Shqipëri për: “Fuqizimin e kapaciteteve institucionale të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtësisë së Ndhmës Juridike Falas (MD / DNJF) në zbatimin e kompetencave të saj për të administruar shërbimin e ndihmës juridike parësore të ofruar”.

¹² Qëllimi i kësaj tryeze konsistonte në rëndësinë dhe efikasitetin që duhet të ketë Sistemi i Ndhmës Juridike Parësore dhe fokusin për të rritur urat e bashkëpunimit ndër-institucional në mënyrë të tillë që çdo qytetari të garantohet akses në Drejtësi.

Drejtësisë si dhe përcjelljen e propozimeve Ministrit të Drejtësisë me **shkresën me nr. 278 prot., datë 23.07.2020.**

Procedura e dhënies të autorizimeve ka përfunduar më datë **10.09.2020**, përmes shpërndarjes së autorizimeve në një aktivitet të organizuar me organizatat jofitimprurëse me pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë. Konkretisht, lista e organizatave jofitimprurëse është si vijon:

Nr.	Emërtimi i OJF-së	Nr. Data e vendimit të MD për dhënien e autorizimit	Selia e organizatës jofitimprurëse të autorizuar
1	“Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza”	295 prot., datë 10.09.2020	Tiranë
2	“Mbrotjtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”	296 prot., datë 10.09.2020	Berat
3	“Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara”	297 prot., datë 10.09.2020	Tiranë
4	“Intelektualët e rinj shpresë”	306 prot., datë 10.09.2020	Shkodër
5	“Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shëqipëri (CRCA)”	305 prot., datë 10.09.2020	Tiranë
6	“Forumi i Gruas Elbasan”	304 prot., datë 10.09.2020	Elbasan
7	“Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”	303 prot., datë 10.09.2020	Tiranë
8	“Të ndryshëm dhe të barabartë”	302 prot., datë 10.09.2020	Tiranë
9	“Albanian Legal and Territorial Institute (ALTRI)”	301 prot., datë 10.09.2020	Tiranë
10	“Qendra për nisma ligjore qytetare”	300 prot., datë 10.09.2020	Tiranë
11	“Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”	298 prot., datë 10.09.2020	Tiranë
12	“Qendra Konsumatori Shqiptar”	299 prot., datë 10.09.2020	Durrës

Në kuadër të mbarëvajtjes së punës, DNJF ka mbatur një kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit e OJFve të autorizuar të përmes:

- Komunikimit periodik me stafin e DNJF;
- Zhvillimit të takimeve të vazhdueshme, përmëndim këtu takimin e datës 10.09.2020, me pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë;
- Pjesëmarrjes në aktivitetete të përbashkëta të zhvilluara nga OJF-të e autorizuar;
- Përcjelljes së raportimeve në baza mujore dhe rasteve të suksesit.

Pas miratimit të autorizimeve nga Ministri i Drejtësisë, është detyrë e DNJF të vijojë me shpalljen e thirrjes për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar, procedurë e cila rregullohet me VKM nr 110 datë 06.03.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për

autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”.

VKM nr. 110 datë 06.03.2019, përcakton me detaje procedurën e cila duhet të ndiqet dhe konkretisht mbi:

- Hartimin dhe publikimin e planit vjetor të financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar;
- Hapjen e thirrjes për aplikime, kriteret e nevojshme që duhet të plotësohen nga këto OJF;
- Ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe komisionit të ankimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim si dhe parimet themelore që duhet të ndiqen në kuadër të vlerësimit;
- **Lidhjen e kontratës së shërbimit dhe elementët që duhet të përmbajë ajo;**
- Mënyrën e kryerjes së monitorimit të cilësisë së shërbimit të ofruar dhe përdorimit të fondeve të përfituara.

Arsyeja e mospërmbushjes së këtij aktiviteti ka të bëjë me problematikat e konstatuara sa i përket VKM nr.110, datë 06.03.2019, “*Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuar, që ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti*”, si dhe Shtojcës 1 të Urdhrit nr. 1 datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë “*Për miratimin e kontratave të ofruesve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti*” të lidhura kryesisht me mënyrën e kryerjes së pagesës për OJF e autorizuar.

Për këtë arsye, me shkresën me nr. 278/1 prot., 490 prot., datë 30.10.2020, si dhe me shkresën me nr. 487 prot., datë 29.10.2020, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim ndërmarrjen e masave për zgjidhjen e këtyre problematikave.

Mungesa e përcaktimeve ligjore lidhur me mënyrën e kryerjes së pagesës passolli mos shpalljen e thirrjes për vitin 2020. Me qëllim mos vijimin e kësaj problematike edhe për vitin 2021, DNJF vijoi me hartimin e propozimeve për ndryshime ligjore (*draftimin e kontratës tip për financimin e OJF-ve*), draft i cili u miratua me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë më datë 31.12.2020. Tashmë, objektiv dhe sfidë për DNJF është përfundimi i procedurave të financimit brenda vitit 2021¹³.

¹³ Në zbatim të neneve 91 e 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Referuar këtij vendimi, për një periudhë 4(katër) mujore përpara datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve janë të përcaktuara në mënyrë eksplicite një sërë veprimtarish/procedurash të ndaluara për t`u zhvilluar nga organet e administratës publike. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, pas analizimit të këtij akti, me shkresën me nr. 19 datë 11.01.2020 vlerësoi të nevojshme dhënien e një orientimi ligjor nga ana e KQZ, nëse veprimtaritë e planifikuara për t`u zhvilluar për 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2021 (referuar planit të punës si dhe Strategjisë 5 vjeçare për ndihmën juridike të garantuar nga shteti) konsiderohen ose jo veprimtari të ndaluara dhe konkretisht: **Veprimtaria nr. 1: Hapja e Qendrave të Ofritit të Shërbimit të**

- **Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.**

Bazuar në nenin 3 dhe 8 të ligjit 111/2017, “Klinikë ligjore” është njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë, pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

Në total për vitin 2020, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur 9 (nëntë) marrëveshje bashkëpunimi, të dhëna specifike mbi të cilat janë parashtruar si vijon:

Nr.	Institucioni i Arsimit të Lartë	Data e lidhjes së marrëveshjes
1	Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetin e Drejtësisë	20 Shkurt 2020
2	Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Bedër	13 Maj 2020
3	Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Wisdom	20 Maj 2020
4	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin European të Tiranës	4 Qershor 2020
5	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës	16 Qershor 2020
6	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Ismail Qemali Vlorë	13 Qershor 2020
7	Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Qiriazhi	30 Shtator 2020
8	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Mesdhetar	24 Nëntor 2020
9	Marrëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin OSFA (Klinika e Ligjit Shkodër)	3 Nëntor 2020

Në funksion të shtrirjes së këtij bashkëpunimi, më datë 28.10.2020, u zhvillua takimi i parë teknik me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me të cilat Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Gjatë këtij takimi u diskutua për rolin që u është atribuar me ligj Klinikave të Ligjit, si ofrues të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike falas dhe masat që duhen ndërmarrë me qëllim vendosjen e tyre në të njëjtën linjë me Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara. Pavarësisht se ndodhemi në kushtet e një viti të ri akademik sfidues, referuar masave kufizuese të ndërmarra për shkak të pandemisë, nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe përfaqësuesve të Klinikave u shpreh angazhimi maksimal dhe gadishmëria për bashkëpunim të mëtejshëm.

Ndhmës Juridike Parësore. Veprimtaria nr. 2: Financimi i OJF-të e autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike. Mbetemi në pritje të dhënies së një përgjigje nga ana e këtij institucioni.

Të gjitha këto Klinika po vijojnë bashkëpunimin me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas qoftë sa i përket raportimit të të dhënave, qoftë sa i përket pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta, përmendim këtu aktivitetin e datës 3 Dhjetor 2020, në bashkëpunim me Klinikën e Ligjit pranë Kolegjit Universitar Wisdom dhe shoqatën “Reze Drite” me qytetarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian në zonën e Shkozës¹⁴.

Gjithashtu, në kuadër të përditësimit të njohurive praktike të studentëve të angazhuar pranë këtyre Klinikave është hapur thirrja për studentët e interesuar që janë duke ndjekur studimet në drejtësi pranë Fakulteteve të Drejtësisë që të angazhohen pranë Klinikave të Ligjit me qëllim përfitimin e njohurive praktike pranë këtyre Klinikave si dhe angazhimin e tyre në kuadër të:

- Pjesëmarrjes në webinare/trajnime të zhvilluara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mbi ligjin për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
- Pjesëmarrje në aktivitete sensibilizuese/edukimin ligjor që publikut të planifikuara për t’u zhvilluar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas përgjatë vitit 2021;
- Zhvillimit të praktikave 3 mujore të punës pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas administron;
- Zhvillimit të praktikave të punës pranë Organizatave Jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë që përfitojnë financim nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore.
- **Ofrimi i ndihmës juridike parësore Online (juristionline.al).**

Në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e pandemisë (Covid-19), u mbyllën qendrat e ndihmës parësore, dhe një pjesë e procesve të punës u pezulluan.

Duke qënë një shërbim ngushtësisht i lidhur me qytetarin, kurrësesi ndihma juridike nuk mund të mos ofrohej dhe në këto kushte kufizimi. Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me OSFA, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka vijuar me ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al**¹⁵.

Kjo platformë ka rezultuar mjaft e sukseshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre ku përgjatë vitit 2020, **janë trajtuar mbi 1467 raste.**

¹⁴ Pjesëmarrësit, si një ndër kategoritë përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, u informuan mbi të drejtat që ligji për ndihmën juridike u garanton dhe mënyrën e përfitimit të ndihmës juridike falas.

¹⁵ <https://juristionline.al/>

DNJF ka ndërmarrë një sërë masash në kuadër të promovimit të kësaj platforme por edhe sa i përket cilësisë së shërbimit të ofruar.

Shërbimi i ndihmës juridike falas quhet së është garantuar në mënyrë të plotë, me eficiencë dhe efektivitet vetëm atëherë kur është ofruar me cilësinë e duhur. Në këtë kuadër, është shumë e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendja e duhur kombinimit të shifrave sasiore me të dhënat e cilësisë së shërbimit. Kombinimi i të dhënave statistikore me cilësinë që ka prodhuar këto të dhëna janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën, si pjesë e një pakete unike shërbimi dedikuar qytetarit. DNJF si institucioni kompetent në kuadër të vlerësimit të cilësisë të këtij shërbimi është duke vijuar të analizojë me kujdes përgjigjet e avokatëve/juristëve të angazhuar në platformë si dhe kohën e kthimit të tyre me qëllim përcjelljen e sugjerimeve në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit, gjë për të cilën do të shprehem në kapitullin nr.5 mbi vlerësimin e ofrimit të cilësisë së shërbimit.

Objektiv për vitin 2021, është zhvillimi i një aplikacioni telefonik për platformën juristionline, ky çdo qytetar do të ketë mundësinë që përmes parashtrimit të kërkesës për orientim ligjor nga telefoni i tyre, të marri një përgjigje në kohë reale nga juristët e angazhuar në këtë platformë.

- Ofrimi i ndihmës juridike parësore nëpërmjet numrit të gjelbër pa pagesë 08001010.

Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike parësore, DNJF me mbështetjen e OSFA, ka vendosur në dispozicion një linjë të gjelbër në të cilën kanë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosja e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. Si platforma juristionline ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime profesionale dhe me standard të lartë dhe duke qenë sa më pranë qytetarit.

Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas rezulton se qytetarët kanë shfaqur mjaft interes në përfitimin e këtij shërbimi ligjor (mbi 310 telefonata) gjë që përbën një hap mjaft pozitiv në kuadër të garantimit të aksesit në drejtësi për qytetarët.

- Administrimi i të dhënave të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 111/2017, DNJF:

a) mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitimin e saj.

Bazuar në këtë dispozitë, me udhëzimin nr.1, datë 08.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave

të regjistruar” janë përcaktuar në mënyrë të detajuar të dhënat që çdo qendër e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të raportojë.

Konkretisht, në pikën 3 të këtij udhëzimi përcaktohet shprehimisht se: “Çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti i dërgon periodikisht çdo muaj Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, të dhënat e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve kërkuese të paraqitura për të përfitur ndihmë juridike të garantuar nga shteti. Të dhënat dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues”.

Në kuadër të përmbushjes së procedurave të përcaktuara në udhëzimin e sipërcituar, me urdhër nr. 307 datë 10.08.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm janë autorizuar koordinatorët përgjegjës për Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore; Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve si dhe Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara. Koordinatorët kanë mbajtur kontaktet me çdo ofrues të ndihmës juridike parësore në kuadër të administrimit të të dhënave; përcjelljen e çdo problematike me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje por edhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta.

Pas administrimit të të dhënave, në baza mujore është proceduar me hartimin e analizave statistikore mbi ndihmën juridike parësore, sipas një formati Tip të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Këto analiza statistikore do të inkorporohen në një produkt të vetëm (analizë statistikore 1 vjeçare për ndihmën juridike parësore) analizë e cila do të publikohet si një produkt i DNJF brenda vitit 2021.

Totali i rasteve të raportuara nga ofruesit e ndihmës juridike parësore për periudhën Janar - Dhjetor 2020 është 4191 raste

Muaji	Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara	Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve	Platforma Juristionline	Numri i gjelbër 08001010	Totali i rasteve të raportuara
Janar-Korrik	837 raste	--	--	765 raste	131 raste	1733
Gusht	60 raste	--	7 raste	146 raste	--	213
Shtator	101 raste	306 raste	13 raste	167 raste	--	587
Tetor	163 raste	196 raste	6 raste	153 raste	12 raste	530
Nëntor	151 raste	292 raste	9 raste	135 raste	45 raste	632
Dhjetor	114 raste	166 raste	6 raste	158 raste	52	496
Total	1426 raste	960 raste	41 raste	1524 raste	240 raste	4191

Kapitulli 4

NDIHMJA JURIDIKE DYTËSORE

- **Bashkëpunimi me avokatët – ofrues të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore.**

Në zbatim të kompetencës së përcaktuar në nenin 8, gërma k¹⁶) të ligjit nr.111/2017 “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*”, për vitin 2020 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka nënshkruar 73 kontrata me avokatët që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore. Në kuadër të kësaj mase të parashikuar në planin e punës për vitin 2020, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike ka vijuar me bashkëpunimin e vazhdueshëm me avokatët në disa drejtime:

- Sa i përket **ndjekjes së çështjeve gjyqësore** të caktuara me vendim të Dhomave Vendore të Avokatisë mbi ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore si dhe monitorimit qoftë ky fillestar por dhe i vazhdueshëm të ecurisë së tyre; *Informacion më të detajuar mbi këtë indikator gjeni tek kapitulli: Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Avokatët e ndihmës juridike dytësore.*
- **Pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në seminare** të lidhura me ndihmën juridike dytësore dhe zbatimin e çështjeve në praktikë: Në këtë kuadër, Drejtoria e Mbikëqyrjes gjatë muajit Nëntor 2020, ka realizuar webinarin me temë “*Mbi standardet e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes së cilësisë së shërbimit*” me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë si dhe ofruesve të ndihmës juridike dytësore, ku fokus i veçantë iu kushtua dhe problematikave të përcjella nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike dytësore mbi zbatimin në praktikë të ligjit nr.111/2017.
- ***Problematikat/rekomandimet e konstatuara, konkretisht si mëposhtë:***
 - **Mungesë bashkëpunimi nga ana e organeve të administratës publike**, me qëllim trajtimin me përparësi të çështjeve të ngritura nga kërkuesit, pjesë e kategorive vunerabël të përcaktuara nga ligji nr.111.2017 “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*”, fakt ky që ka sjellë vonesa në marrjen e dokumentacionit provues nga ana e përfaqësuesve ligjorë dhe përpilimin e dokumentave për të investuar gjykatën;
 - Shumica e organeve shtetërore (Policia e Shtetit, Prokuroria etj.) **nuk i njohin formularët për ndihmë juridike të garantuar nga shteti, mosdisponimi i të**

¹⁶ DNJF lidh, deri më 1 Mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.

cilëve passjell mosinformim të personave të arrestuar/ të ndaluar të pandehurve sa i përket të drejtës së tyre themelore kushtetuese - për t'u pajisur me mbrojtës falas nga shteti.

- **Përcaktim i kriterëve më të zbutura** për përzgjedhjen e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore, me qëllim përpilimin e një listë gjithëpërfshirëse të tyre, për nënshkrimin e kontratave të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore.

- Një ndër problematikat¹⁷ me të cilat Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është hasur në praktikë lidhet me mbrojtjen e detyrueshme të të pandehurve në proces gjyqësor. **Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** ka bërë disa kërkesa drejtuar Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas përmes të cilave ka kërkuar garantimin e mbrojtjes së detyrueshme për të pandehurit, në kushtet kur mbrojtësit e zgjedhur kryesisht nuk janë paraqitur në seancat gjyqësore në mënyrë të përsëritur.

- **Trajnimit të avokatëve** ofrues të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore: Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndihmës Juridike i është drejtuar me shkresë Dhomes së Avokatisë së Shqipërisë (DHASH), në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional me DHASH, bazuar në kompetencat që rrjedhin nga ligji Nr.111/2017¹⁷“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, neni 9, gërma d) , e cila parashikon si detyrë të Dhomes së Avokatisë së Shqipërisë *d) përgatitjen dhe organizimin*

¹⁷ Në këtë pikë, përballemi me dy sisteme të ndryshme. Nga njëra anë sistemi i avokatëve të ndihmës juridike dytësore të garantuar nga shteti dhe nga ana tjetër sistemi i avokatëve mbrojtës të caktuar kryesisht.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, në nenin 49 të tij ka parashikuar se: “*Kur mbrojtja nuk mund të sigurohet sipas kësaj dispozite dhe pikës 3, të nenit 49, mbrojtja garantohet nga institucionet që administrojnë ndihmën juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi*”. (ligji nr.111/2017¹⁷“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”). Sipas ligjit 111/2017, “*ndihma juridike dytësore*” është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal. Gjithashtu, në vendimin e KLP nr. 231, datë 12.11.2019, i cili ka miratuar rregullat dhe procedurat që ndiqen nga organi procedues që fillon hetimet, për caktimin mbi bazë të parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës dhe zëvendësimin e tij nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal, parashikohet se: “*Kur mbrojtja e detyrueshme nuk mund të sigurohet nga lista e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, mbrojtja garantohet nga lista e avokatëve që ofrojnë Ndihmë Juridike Dytësore në procesin penal*”.

Nëse i referohemi dispozitave ligjore të mësipërme, qëllimi i tyre nuk është të mbivendosen dy sistemet e sipërpërmendura por të jenë plotësues të njëri-tjetrit në funksion dhe në përbushje të të drejtës kushtetuese të garantimit të mbrojtjes ligjore referuar nenit 31 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Nëse do të lexojmë dispozitat e ligjit të posaçëm për ndihmën juridike, vihet re se ndihma juridike dytësore (mbrojtja me avokat nga lista e ofruesve të ndihmës juridike dytësore), ofrohet në çështjet penale për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal. Në rastet e referuara nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, jemi në kushtet kur nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme sipas nenit 49 të KPP-së.

Sa i përket procedurës që duhet të ndiqet për të përfutur shërbimin e ndihmës juridike dytësore, referuar ligjit nr.111/2017, *organi kompetent për dhënie e vendimit nuk është Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, por gjykatat dhe organi procedues, në varësi të pozitës procedurale të kërkuarit. Në këto kushte, nëse provohet se kërkuari është i pandehur pa mjete të mjaftueshme financiare , organi procedues që fillon hetimet shqyrton menjëherë nëse përbushen kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji. Nëse organi procedues që fillon hetimet vlerëson se kriteret janë përbushur, cakton menjëherë një avokat mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe njofton menjëherë personin, të cilit i ofrohet ndihmë juridike dytësore, si dhe avokatën e caktuar mbrojtës.*

e programeve të trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas. Në këtë kuadër, DNJF ka hartuar draft programin e trajnimit vazhdues të ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, në të cilin janë parashikuar tema specifike duke u përqëndruar kryesisht në ligjin nr. 111/2017, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu, në fokus të veçantë për trajnimin vazhdues, DNJF ka parashikuar edhe nëntema të lidhura specifikisht me kategoritë e veçanta përfituese/grupet vulnerabël, sikurse parashikohen në ligj.

- **Bashkëpunim për çdo problematikë dhe çështje që haset në praktikë** nga avokatët - ofrues të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore apo nga DNJF: Në përmbushje të këtij indikatorit, bazuar dhe në problematikat e përcjella nga ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike ka vendosur kontaktet me kryetarët e Dhomave Vendore të Avokatisë për të realizuar një takim me qëllim bashkëpunimin mbi zgjidhjen efikase të problematikave të konstatuara gjatë zbatimit në praktikë të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, por për shkak të situatës së pandemisë Covid 19, ky takim nuk u bë i mundur të realizohej brenda muajit Dhjetor të vitit 2020.

Tematikat mbi takimin e parashikuar për t’u zhvilluar me Dhomat Vendore të Avokatisë evidentohen si më poshtë:

- **Dakordësimin e kriterëve të përcaktuara për përzgjedhjen e ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike**, sipas listave të përpiluara nga Dhomat Vendore të Avokatisë, mes DHASH dhe DNJF, kompetencë kjo e parashikuar nga Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” Neni 9 “Detyrat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë” Dhoma Kombëtare e Avokatisë kryen këto detyra: a) miraton me udhëzim të përbashkët me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore.
- **Zbatueshmërinë brenda afateve ligjore të vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore, mbi:**
 - Caktimin e avokatit që do të përfaqësojë kërkuesin në procesin gjyqësor;
 - Njoftimin e vendimeve të Dhomave Vendore të Avokatisë për caktim avokati që do të ofrojë shërbimet e ndihmës juridike. *(Kompetencë kjo e parashikuar nga Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” nenin 24 të ligjit të sipërpërmendur “Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga avokatët” si dhe Udhëzimit*

*të përbashkët nr.18, datë 05.08.2020 “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative”¹⁸, parashikohet: 2.Në rast të pranimit të kërkesës për ndihmë juridikedytësore veprohet sipas rregullave të mëposhtme: a) dhoma vendore e avokatisë cakton një avokat nga lista e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore, **sipas parimit të rotacionit**; b) dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit, këtij të fundit dhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore. 4. Avokati i caktuar, menjëherë pasi njihet me vendimin e gjykatës kompetente dhe vendimin e dhomës vendore të avokatisë ose me vendimin e organit procedues mbi caktimin e tij si avokat për dhënien e ndihmës juridike dytësore, hyn në marrëdhënie me personin, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe fillon dhënien e shërbimeve të kërkuara).*

- Edhe në rastet e caktimit të avokatit nga Dhomat Vendore, problematika vijon për shkak të mosnjohimit në mënyrë të rregullt dhe në kohë të Drejtorisë, duke sjellë kështu mungesë së të dhënave jo vetëm në funksion të plotësimit të detyrave për sa i përket mbajtjes së të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve por, më gjerë dhe në funksion të monitorimit të vazhdueshëm të avokatëve për çështjet e reja të marra në shqyrtim.
- **Vijueshmëria e trajnimit të vazhdueshëm për ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore.**

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional me DHASH, bazuar në kompetencat që rrjedhin nga ligji Nr.111/2017”Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, neni 9, gërma d) parashikon si detyrë të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisëd) *përgatitjen dhe organizimin e programevetë trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, DNJF ka hartuar draft programin e trajnimit vazhdues të ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore,në të cilin janë parashikuar tema specifike duke u përqëndruar kryesisht në ligjin nr. 111/2017, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu, në fokus të veçantë për trajnimin vazhdues kemi parashikuar edhe nëntema të lidhura specifikisht me kategoritë e veçanta përfituese/grupet vulnerabël, sikurse parashikohen në ligj.*

¹⁸Me miratimin e aktit nënligjor Udhëzimi i përbashkët MD dhe DHASH “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative” kreu II - afati për caktim avokati nga Dhoma Vendore është **8 orë**, nga marrja e vendimit të gjykatës për pranim kërkesë për NJ dytësore dhe ka detyrimin të njoftojë menjëherë DNJF për caktimin e avokatit.

Theksojmë, rëndësinë e këtij bashkëpunimi si institucione përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike dytësore duke theksuar dhe rëndësinë e kontributit dhe bashkëpunimit në këtë proces.

- **Raportimi me cilësi dhe në afat i të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, sipas Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë me nr. 1, datë 08.03.2019.**

DNJF në zbatim të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe sipas Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë me nr. 1, datë 08.03.2019 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave” plotëson dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfitues të ndihmës juridike me depozitimin e informacionit pranë Drejtorisë, sipas pikës 3 të këtij udhëzimi ku përcaktohet se:

“Çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti i dërgon periodikisht çdo muaj Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, të dhënat e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve kërkuese të paraqitura për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti. Të dhënat dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.”

- **Njohje dhe zbatim i aktit nënligjor – metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga DNJF të shërbimeve të ndihmës juridike”, miratuar me Urdhër nr. 531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë.**

Gjithashtu mbi çdo problematikë të konstatuar nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndihmës Juridike mbi zbatimin e ligjit nr. 111/2017 nga ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore¹⁹, kemi vënë në dijeni DHASH si institucioni kompetent për vendimmarrjen eventuale.

- **Administrimi i plotë i të dhënave** mbi shërbimin e ndihmës juridike dytësore. *(Caktimi i dy koordinatorëve për avokatët e ndihmës juridike dytësore me qëllim zhvillimin e takimeve orientuese; administrimin e të dhënave dhe përcjelljen e çdo problematike, konkretisht: plotësimi i databasave sipas përcaktimeve të ligjit dhe mbajtja e të dhënave e statistikave për të gjitha vendimet gjyqësore si dhe për çdo kërkesë që bëhet nga DNJF në funksion të sistemit të ndihmës juridike dytësore. zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta etj).*

Lidhur me këtë masë, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DNJF nr. 308, datë 10.08.2020, janë caktuar dy specialistë përgjegjës për administrimin e të dhënave të ndihmës juridike dytësore.

¹⁹ Këtu i referohemi shkresave drejtuar DHASH për procedim disiplinor ndaj ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore.

Në këtë kuadër, është vijuar me plotësimin e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve, sipas formatit të miratuar me udhëzim nr.1, datë 08.03.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të rregjistrave”, bazuar në vendimet gjyqësore të administruara nga DNJF. Gjithashtu, është vijuar me hartimin analizës statistikore mbi vendimet gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore falas, analizë e cila është hartuar çdo muaj dhe pasqyron kërkesat e paraqitura për përfitim të shërbimit të ndihmës juridike dytësore falas, shifrat dhe llojin e çështjeve gjyqësore, vendimet e ankimuar, caktimin e avokatëve etj, duke parë tendencën e kërkesave të paraqitura, si dhe duke evidentuar problematikat e gjetura për zbatim të ligjit dhe rekomandime.

TË DHËNA STATISTIKORE

JANAR – DHJETOR 2020

<i>Vendime Gjyqësore me Objekt Ndihmën Juridike</i>						
<i>Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore</i>	<i>Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore</i>	<i>Pranim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Rrëzim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Kthim aktesh/pushim çështjeje/cështje në gjykim/moskompetencë/</i>
102	20	17	-	38	1	3
Totali i Vendimeve Gjyqësore = 181						

- **Ndjekja e vendimeve gjyqësore** me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore. (Bashkëpunimi me gjykatat për komunikimin e vendimeve gjyqësore dhe ndjekja e ecurisë dhe zbatimit të tyre²⁰; bashkëpunimi me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë dhe me Dhomat Vendore në kuadër të caktimit të avokatit që do të përfaqësojë kërkuuesin në procesin gjyqësor; ankimimi i vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga shpenzimet / tarifat gjyqësore, nëse provohet se kjo kërkesë është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar; Kërkesë për ndreqje gabimesh në vendimet gjyqësore për përfitim ndihme juridike dytësore).

²⁰ Të mbahen të dhëna për çdo vendim që komunikohet në DNJF, për çdo kërkesë që kjo e fundit i drejton gjykatave, Dhomës së Avokatisë apo çdo institucioni tjetër të përfshirë.

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike ka vijuar me ndjekjen e vendimeve gjyqësore të cilat administrohen nga DNJF me objekt: përfitim ndihme juridike dytësore si dhe përjashtim nga pagimi i tarifave apo shpenzimeve gjyqësore, me qëllim zbatueshmërinë e tyre nga institucionet përgjegjëse. Të gjitha vendimet e administruara me objekt ndihmën juridike janë analizuar dhe është vijuar me përpilimin e dokumentacionit, në varësi të dispozitivit të vendimit gjyqësor përkatës:

- Kërkesë (qoftë me shkresë apo me e-mail zyrtar) Dhomave Vendore të Avokatisë për caktim të avokatit që do të ofrojë shërbimin e ndihmës juridike dytësore për kërkuesin/kërkuesen, bazuar në listën e ofruesve të ndihmës juridike dytëore që kanë nënshkruar kontratën e shërbimit me DNJF;
- Plotësim vendimi / ndreqje gabimi, në varësi të problematikave të konstatuara në vendimet e gjykatave në drejtimet e mëposhtme:
 1. përvetësim i kompetencave të Dhomës Vendore të Avokatisë duke caktuar vetë Gjykata, avokatin që do të përfaqësojë kërkuesin në procesin gjyqësor, qoftë ky avokat që ka lidhur kontratë shërbimi me DNJF apo që nuk ka lidhur kontratë shërbimi me DNJF;
 2. mosdiponim për të gjitha kërkimet e kërkuesit sipas objektit: përfitim ndihme juridike dytësore si dhe përjashtim nga pagimi i tarifave apo shpenzimeve gjyqësore;
 3. moskomunikim vendimi gjyqësor me objekt përfitim ndihme juridike dytësore kërkuesit, DNJF apo Dhomave Vendore të Avokatisë;
 4. mospërcaktim i të drejtës së ankimit ndaj vendimit gjyqësor;
 5. përcaktim i gabuar i afatit për ankim të vendimit gjyqësor.
- Ankim sipas përcaktimeve të ligjit.
- **Hartimi i një materiali përmbledhës** për ndihmën juridike dytësore, në të cilin të përfshihen: ***të gjitha vendimet gjyqësore me këtë objekt; statistika të prodhuara nga këto vendime (sa është nr. Total i vendimeve, sa janë refuzime sa janë pranime për ndihmë juridike, sa janë ankimuar prej tyre nga ana e DNJF, për sa prej tyre është bërë kërkesë për ndreqje gabimesh, sa kërkesa të tjera ka me objekt bashkëpunim në funksion të ndihmës dytësore, etj); konstatime e problematika dhe përpjekjet e bëra nga DNJF për të adresuar drejt problematikat dhe për të gjetur mundësi e rrugë të reja bashkëpunimi.***

Pas administrimit të vendimeve gjyqësore dhe mbajtjes së të dhënave statistikore, Drejtoria e Mbikëqyrjes ka vijuar me hartimin e një analize përmbledhëse për ndihmën juridike dytësore. Në këtë analizë pasqyrimi i të dhënave gjithashtu evidenton dhe volumin e punës mbi vendimmarrjet e gjykatave mbi kërkesat e paraqitura për përfitim të shërbimit të ndihmës juridike dytësore falas, vendimet gjyqësore me objekt ndihmën juridike dytësore të ndara

respektivisht për pranime/refuzime kërkesash për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, krahasimin e ecurisë së dhënies së ndihmës juridike dytësore mbi bazën e të dhënave si dhe çfarë zëri këto vendime ndjekin nga buxheti i shtetit.

Kapitulli 5

VLERËSIMI I CILËSISË SË SHËRBIMIT TË OFRUAR

Një komponent shumë i rëndësishëm i ofrimit të ndihmës juridike falas është cilësia e këtij shërbimi. Shërbimi i ndihmës juridike falas quhet së është garantuar në mënyrë të plotë, me eficiencë dhe efektivitet vetëm atëherë kur është ofruar me cilësinë e duhur. Në këtë kuadër, është shumë e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendja e duhur kombinimit të shifrave sasiore me të dhënat e cilësisë së shërbimit. Kombinimi i të dhënave statistikore me cilësinë që ka prodhuar këto të dhëna janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën, si pjesë e një pakete unike shërbimi dedikuar qytetarit.

Referuar nenit 8 të Ligjit nr.111/2017, (pika I dh II), DNJF zbaton sistemin e vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike dhe mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët.

Në zbatim të këtyre parashikimeve, me Urdhrin nr. 534, datë 25.11.2019, “*Për miratimin e kritereve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike*”, është miratuar metodologjia që do të ndiqet për të vlerësuar dhe mbikëqyrur cilësinë e shërbimeve të ofruara të ndihmës juridike.

Ky dokument shpjegon nocionin e ndihmës juridike, referuar ndihmës juridike parësore dhe dytësore, shërbimet që përfshin secila ndarje, qëllimet që ndjek ndihma juridike referuar ligjit 111/2017, metodologjinë e vlerësimit dhe procedurat e mbikëqyrjes dhe koordinimit.

- *Metodologjia e vlerësimit si dhe baza ligjore.*

Qëllimet e ndihmës juridike falas janë udhëzuesi i mënyrës së ushtrimit të kësaj veprimtarie. Më konkretisht veprimtaria e ndihmës juridike falas, duhet të ushtrohet në mënyrë të tillë që të krijojë akses në drejtësi edhe për qytetarët me vështirësi ekonomike, duhet të jetë e mirëorganizuar, e mirëadministruar dhe funksionale; dhe duhet të garantojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike të cilat të jenë profesionale, cilësore, eficientë dhe efektive.

Metodologjia e përdorur për ushtrimin e kontrollit është e përcaktuar në Urdhrin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë në të cilin janë përcaktuar disa indikatorë mbi bazën e të cilëve do të kryhet vlerësimi.

Në përmbushje të këtij detyrimi, Drejtoria e Mbikëqyrjes vijuar me vlerësimin e cilësisë së shërbimit për të gjithë ofruesit e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, konkretisht:

- **Vlerësimi i cilësisë** së shërbimit të ofruar nga **Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore**²¹ (*Kryerja e monitorimit fillestar për çdo qendër të re të shërbimit të ndihmës juridike parësore; kryerja e monitorimeve tremujore për qendrat e ndihmës juridike parësore; monitorimi dhe kontaktimi i vazhdueshëm me qendrat; dërgimi i raporteve mujore narrative mbi ecurinë e punës; hartimi i raporteve të monitorimit / vlerësimi i performances*).

1. Monitorimi i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës juridike në **Tiranë**.

- Monitorimi tre mujor i kryer më datë 13.08.2020 si dhe monitorimi i vazhdueshëm i kryer me datë 22.12.2020;
- Analizë e Raporteve mujore narrative.

2. Monitorimi i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në **Durrës**.

- Monitorimi tre mujor i kryer më datë 15.07.2020;
- Analizë e Raporteve mujore narrative.

3. Monitorimi i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në **Fier**.

- Monitorimi tre mujor i kryer më datë 23.07.2020;
- Analizë e Raporteve mujore narrative.

4. Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në **Lezhë**.

- Monitorimi tre mujor i kryer më datë 11.08.2020;
- Analizë e Raporteve mujore narrative.

5. Monitorimi i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në **Lushnje**:

- Monitorimi i kryer më datë 04.12.2020
- Analizë e Raporteve mujore narrative.

6. Monitorimi i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike në **Pogradec**.

- Analizë e Raporteve mujore narrative.
- Në proces, datë 30.12.2020 monitorimi pranë ambjenteve të qendrës.

7. Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në **Gjirokastrë**

²¹ Raportin Përmbledhës të monitorimeve e gjeni bashkëlidhur.

- Analizë e Raporteve mujore narrative.

8. Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në **Shkodër**

- Analizë e Raporteve mujore narrative.

Pas kryerjes së monitorimeve janë hartuar raportet përmbledhëse sipas përcaktimeve të metodologjisë së miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Gjithashtu, jemi në proces të hartimit të raporteve përfundimtare të performancës për juristët / avokatët e çdo qendre shërbimi. Është hartuar raporti përmbledhës për të gjitha monitorimet e kryera për ndihmën juridike parësore. (E gjeni bashkëlidhur këtë raport).

- **Vlerësimi i cilësisë** së shërbimit të ofruar nga **Avokatët e ndihmës juridike dytësore** (*Kryerja e monitorimit fillestar për çdo avokat të ndihmës juridike dytësore; kryerja e monitorimit të vazhdueshëm për çdo avokat të ndihmës juridike dytësore; hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës*).

Procesi i mbikëqyrjes ka vijuar edhe për avokatët e ndihmës juridike dytësore përmes kryerjes së monitorimeve fillestare pranë zyrave të avokatëve me të cilët DNJF ka lidhur kontratë për ofrimin e shërbimit si dhe monitorimit të vazhdueshëm dhe ndjekjes së ecurisë së çështjeve të caktuara me vendim të Dhomave Vendore të Avokatisë. Pas kryerjes së monitorimeve janë hartuar raportet përmbledhës sipas anekseve të bashkalidhura metodologjisë, ku është realizuar monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm për të 73 ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore. Hartimi i raporteve përfundimtare të vlerësimit të performancës për avokatët që kanë përfunduar çështjet e ndihmës juridike është në proces dhe përfundon javën e dytë të muajit Janar 2021, në përfundim dhe të kontratës vjetore lidhur me DNJF për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore. Gjithashtu, ka përfunduar raporti përmbledhës për të gjitha monitorimet e kryera për avokatët e ndihmës juridike dytësore, duke evidentuar dhe përcjellë dosjet e përfunduara pranë Drejtorisë së Financës, me qëllim kryerjen e pagesës për shërbimet e ofruara.

- **Vlerësimi i cilësisë** së shërbimit të ofruar **përmes platformës** juristionline.al (Mbikëqyrja e shërbimit online të ndihmës juridike falas të ofruar përmes platformës juristionline.al; hartimi i raporteve të mbikëqyrjes dhe përcjellja e rekomandimeve përkatëse).

Përgjatë vitit 2020, DNJF ka vijuar me mbikëqyrjen e shërbimit online të ndihmës juridike të ofruar përmes platformës. Janë hartuar raportet përmbledhëse të monitorimit duke përcjellë gjetje dhe rekomandime për juristët e angazhuar në platformë.

Kapitulli 6

FORCIMI I KAPACITETEVE TË STAFIT TË DNJF DHE OFRUESVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

- Forcimi i kapaciteteve të Stafit të DNJF

Bashkëpunimi me Euralius

Stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas më datë 10.12.2020, pati mundësinë të zhvillonte trajnimin e organizuar nga Euralius V mbi ligjin “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” me pjesëmarrjen e ekspertëve të kontraktuar nga Euralius, Z. Thomas Traar dhe Zj. Arta Vorpsi. Stafi pati mundësinë të diskutonte në terma teknikë mbi problematikat e hasura në praktikë nga kuadri ligjor i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta duke marrë në konsideratë dhe praktikën ndërkombëtare.

Trajnime të kësaj natyre do të zhvillohen në vijimësi edhe përgjatë vitit 2021, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare në kuadër të aktiviteteve/projekteve të përbashkëta të cilat do të parashtrihen më në detaje në kapitullin 7 të këtij raporti.

Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës

Në muajin Nëntor 2020, DNJF me shkresën me nr.610 prot., datë 25.11.2020, i është drejtuar Shkollës së Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë me qëllim përfshirjen e DNJF në aktivitetet trajnuese që planifikohen të organizohen në vijimësi në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti me qëllim shkëmbimin e përvojës së ndërsjellë dhe evidentimin e nevojave që sjell në praktikë zbatimin e këtij ligji. Nga ana e Shkollës së Magjistraturës me shkresën me nr. 610/1 prot., datë 17.12.2020, është dakordësuar pjesëmarrja e stafit të DNJF në trajnimet që ky institucion do të zhvillojë përgjatë vitit 2021 në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

- Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

DNJF ka patur një komunikim të vazhdueshëm me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASP), me qëllim dakordësimin mbi zhvillimin e trajnimeve për punonjësit me trajnim të posaçëm, si detyrim ligjor i parashikuar në shkronjën “g”, të nenit 8 të ligjit nr.111/2017, në të cilin parashikohet se: “Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike për miratimin e programeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për punonjësit me trajnim të posaçëm, mbikëqyr zbatimin e tyre dhe rishqyrton periodikisht standardet për trajnimin dhe performancën profesionale të punonjësve me trajnim të posaçëm”.

Nga ana e ASPA-s, me shkresën me nr. 7006/4 prot., datë 31.01.2020, u miratua Draft Programi i trajnimeve (trajnimi fillestar i detyrueshëm), hartuar nga DNJF për punonjësit me trajnim të posaçëm pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Nga ana tjetër, me shkresën me nr. 386/2, datë 22.05.2020, ASPA bën me dije se referuar VKM nr. 138, datë 12.03.2014 “Për rregullat e organizimit dhe funksionimit të ASPA-s dhe trajnimin e nëpunësve civilë”, konkretisht

kreu III, përcaktohet se: “Për personat jashtë shërbimit civil (*siç janë punonjësit me trajnim të posaçëm, marrëdhënia e të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës*), paguhet tarifa prej 3000 (tre mijë) deri në 7000 (shtatë mijë) lekë për kurs trajnimi, në varësi të kohëzgjatjes së kursit”.

Sa më sipër, në kushtet kur buxheti i DNJF është i pamjaftueshëm për trajnimin e detyrueshëm e punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF kërkoi nga ana e UNDP mbështetjen qoftë atë financiare (pagesa e trajnimeve të ASPA-s), ose qoftë përmes zhvillimit të këtij trajnimi nga ana e një eksperti të kontraktuar.

UNDP u shpreh e gatshme për zhvillimin e një trajnimi paraprak të punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore përmes angazhimit të disa ekspertëve dhe më datë 24.09.2020, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas u zhvillua sesioni i parë trajnues gjatë të cilit punonjësit e qendrave patën mundësi të diskutojnë në terma praktikë ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike sipas kategorive specifike të ligjit.

Ky trajnim i paraprak zhvillimit të trajnimeve të detyrueshme të punonjësve nga ana e ASPA me bashkëpunimin dhe mbështetjen e UNDP. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, më datë 14 Dhjetor 2020, u mundësua zhvillimi i një takimi të përbashkët mes UNDP, DNJF dhe ASPA ku u diskutua në mënyrë të përgjithshme mbi:

- Hartimi i kurrikulës (nëse ka një tekst bazë; printimi duhet të jetë në standard afatgjatë; nëse ky modul mund të përdoret nga Aspa për trajnime në vijim);
- Pjesëmarrësit kanë mundësi që të reflektojnë mbi leksionet e marra gjatë sesionit të trajnimit dhe ti paraqesin këto reflektime në sesionin vijues;
- Dhënia e çertifikatës (çertifikata bazohet në një proces vlerësimi i cili kryhet specifikisht sipas nevojave të çdo pjesëmarrësi. Vlerësimi mund të bëhet përmes caktimit të detyrave / një prezantimi nga trajnuesi për pjesëmarrësit sipas nevojave që ata kanë prezantuar edhe gjatë trajnimit);
- U theksua bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike sa i përket këtij projekti;
- Punonjësit e Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (për qendrat aktualisht të hapura dhe ato që do të hapen në vijim), janë target grupi i parë që do të trajnohen;
- Nevojat për trajnim janë reflektuar në termat e referencës të cilat janë diskutuar dhe rënë dakord me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. (është diskutuar në disa takime me DNJF lidhur me nevojat konkrete për trajnim të punonjësve të qendrave);
- Moduli që do të hartohet për këto trajnime mund të përdoret nga të gjithë ata që ofrojnë shërbime (inkurajohet përdorimi i gjerë i këtij moduli); Do të jetë 1 Modul trajnimi i cili do të përfshijë disa tematika ashtu sikurse parashikohet në ligj dhe sikurse e kërkojnë nevojat e punonjësve.

Objektivi i DNJF është zhvillimi i këtyre trajnimeve brenda 6 mujorit të parë të vitit 2021, duke u reflektuar në mënyrë të detajuar në Planin e ri të Punës.

- **Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.**

DNJF, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional, i është drejtuar DhASh me shkresë Nr. 396 Prot., datë 01.10.2020, bazuar në kompetencat që rrjedhin nga ligji Nr.111/2017 *”Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*, neni 9, gërma d) parashikon si detyrë të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë përgatitjen dhe organizimin e programeve të trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

Ky parashikim ligjor gjen mbështetje dhe në ligjin nr. 55/2018 *“Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”*, ku në kapitullin VII *“Edukimi profesional i avokatit”* nenet 52 e 55, 30 përcaktohet se: Avokatët që do të përfshihen në listën e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, kryejnë trajnim specifik mbi fusha të së drejtës të lidhura me kategoritë përfituese të ndihmës juridike dytësore, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, duke ia atribuar këtë kompetencë Shkollës së Avokatisë, si organ i ngritur për të realizuar këtë qëllim.

DNJF ka lidhur kontrata për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore për vitin 2020 me 73 avokatë në rang vendi, listuar sipas Dhomave Vendore të Avokatisë. Si rrjedhojë, nga ana jonë është propozuar që trajnimi vazhdues të zhvillohet për të 73 ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore. Në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka hartuar draft programin e trajnimit vazhdues të ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, në të cilin janë parashikuar tema specifike duke u përqëndruar kryesisht në ligjin nr. 111/2017 *”Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu, në fokus të veçantë për trajnimin vazhdues janë parashikuar edhe nëntema të lidhura specifikisht me kategoritë e veçanta përfituese/grupet vulnerabel, sikurse parashikohen në ligj.

Objektiv i DNJF është zhvillimi i këtyre trajnimeve brenda 6 mujorit të parë të vitit 2021, duke u reflektuar në mënyrë të detajuar në Planin e ri të Punës.

- **Zhvillimi i Webinareve nga DNJF**

Në kuadër të njohjes së ofruesve të shërbimit me procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore qoftë sa i përket raportimit të të dhënave, qoftë sa i përket procedurës së mbikëqyrjes së cilësisë së shërbimit, DNJF ka zhvilluar disa webinare me qëllim diskutimin më në detaje të akteve nënligjore dhe konkretisht:

1. **Webinar datë 29 Tetor 2020**, *“Mbi procedurën e administrimit të të dhënave dhe raportimit nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore”*, me pjesëmarrjen e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara dhe Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve. Qëllimi kryesor i këtij webinarit ishte diskutimi në terma teknikë dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit në kuadër të rasteve të trajtuara, mbajtjes të të dhënave dhe administrimit të tyre sipas formateve të reja të përcaktuara nga aktet nënligjore. Janë pikërisht këto të dhëna, të administruara nga të gjithë ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike të cilat do të shërbejnë për hartimin e

politikave të ndryshme në këtë kuadër si dhe do të jenë një indicie për evidentimin e nevojave për ndryshime ligjore.

2. **Webinar datë 22 Nëntor 2020**, “Mbi Standardet e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes së cilësisë”, me pjesëmarrjen e
- Avokatëve të ndihmës juridike dytësore;
 - Përfaqësues nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë;
 - Përfaqësues nga Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë;
 - Përfaqësues nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore dhe
 - Përfaqësues nga Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara.

Qëllimi kryesor i këtij webinar i ishte diskutimi në terma teknike dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore në kuadër të standardeve të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes së cilësisë. Diskutimi u përqëndrua në disa tematika kryesore si: Risitë e ligjit nr.111/2017, në kuadër të mekanizimit të mbikëqyrjes së cilësisë; Standardet e reja dhe indikatorët e vlerësimit të sanksionuara në Metodologjinë e miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë dhe zbatimi në praktikë referuar problematikave të nxjerra nga monitorimet e kryera.

Kapitulli 7

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE MBËSHTETËSE (EURALIUS V, UNDP DHE OSFA)

- **Bashkëpunimi me Euralius V**

Një ndër partnerët mbështetës të drejtorisë në kuadër të çështjeve të ndihmës juridike falas është EURALIUS, i cili ka parashikuar 2 aktivitete kryesore të lidhura me fushëveprimtarinë e drejtorisë, si vijon:

- 1.4.1: Mbështetje Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera në organizimin, administrimin dhe shpërndarjen e ndihmës juridike parësore dhe dytësore;
- 1.4.2: Mbështetje në krijimin dhe forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera/organizatave të përfshira në administrimin dhe dhënien e ndihmës juridike.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve EURALIUS është angazhuar në mbështetje të Drejtorisë së Ndihmës Juridike si vijon:

- *Strategjia 5 vjeçare për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti.*

Objektivi madhor i kësaj strategjie është: “Përmirësimi dhe rritja e aksesit në drejtësi për grupet vulnerabël në kuadër të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore të garantuar nga shteti në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë”. Në këtë strategji janë parashikuar disa objektiva strategjike në përmbushje të të cilëve, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, nën mbështetjen dhe asistencën teknike të ekspertëve të Euralius është duke hartuar një plan konkret veprimi.

Konkretisht, Strategjia dhe Plani i veprimit synon të përmbushë **objektin e përgjithshëm**: “Kontributi në përmirësimin e aksesit në drejtësi për grupet në nevojë dhe grupet me burime të pakta si në formën e këshillimit të përgjithshëm që ka të bëjë me të gjitha çështjet e lidhura me drejtësinë, të cilat mund të ndikojnë në to (Ndihma juridike parësore falas) dhe çështjet specifike që ata ngrenë ose me të cilat përballen në gjykata (ndihma juridike dytësore).”

Ky objektivi madhor konkretizohet në një **objektiv specifik** dhe konkretisht: “Një sistem funksional NJF që funksionon sipas praktikave më të mira të BE-së që siguron qasje efektive dhe efikase në drejtësi për grupet vulnerabël në Shqipëri”.

Këto objektiva kanë të përcaktuar edhe 3 indikatorë në bazë dhe në zbatim të të cilëve janë hartuar dhe do të implementohen të gjitha masat dhe aktivitetet e parashikuara:

Indikator A: Rritja e ndërgjegjësimit të viktimave, dëshmitarëve, ankuesve dhe personave të akuzuar për të drejtat e tyre për ndihmë dhe qasje në institucione që mund të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre. Matur në përqindje.

Ky indikator do të matet përmes zhvillimit të sondazheve të ndryshme të cilat do të realizohen me mbështetjen e Euralius.

Indikator B: % e popullsisë së Shqipërisë që jeton në zona ku ofrohet shërbimi i ndihmës juridike parësore

Aktualisht, bazuar në analizën e realizuar nga DNJF, mbulohet me shërbime të ndihmës juridike parësore 75% -80 % të territorit sipas qarqeve (referuar statistikave zyrtare të INSTAT_ Janar 2020_sipas ndarjeve administrative në Shqipëri). Në total ka 12 qarqe (Tiranë, Elbasan, Durrës, Fier, Lezhe, Berat, Shkoder, Vlore, Gjirokaster, Korce, Kukes, Diber). Aktualisht, janë duke operuar ofruesit e ndihmës juridike parësore (qendrat e ndihmës juridike parësore, OJQ-të e autorizuara dhe Klinikat Ligjore) në 10 qarqe. Objektivi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në përmbushjen e këtij indikator është zgjerimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore në çdo qark të pambuluar me qëllim që në përfundim të periudhës 5 vjeçare, shtrirja të jetë në masën 100%.

Indikator C: % e popullsisë së Shqipërisë që jeton në zona ku ofrohet shërbimi i ndihmës juridike dytësore

Aktualisht, bazuar në analizën e realizuar nga DNJF, mbulohet me shërbime të ndihmës juridike dytësore 75% e territorit sipas qarqeve. Aktualisht, janë duke operuar ofrues të ndihmës juridike dytësore në 11 qarqe (përveç qarkut të Dibrës). Përqindja prej 75% është llogaritur duke referuar numrin e avokatëve që po ofrojnë ndihmë juridike dytësore për secilin qark. Qarku i Tiranës ka numrin më të lartë të avokatëve në lidhje me numrin e popullsisë së kryeqytetit. Qarqet e tjera kanë mesatarisht 2 avokatë që veprojnë. Objektivi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në përmbushjen e këtij indikator është zgjerimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore në çdo qark të pambuluar me qëllim që në përfundim të periudhës 5 vjeçare, shtrirja të jetë në masën 100%.

Aktualisht, është bërë e mundur finalizimi i Draft Strategjisë dhe Planit të saj të Veprimit. Mbetemi në pritje të miratimit të kësaj strategjie si pjesë integrale e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

- *Manual i Ligjit nr.111/2017 dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij.*

Një tjetër aktivitet i parashikuar në planin e punës të Euralius në mbështetje të drejtorisë është dhe hartimi i një manuali për Ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij. Ky draft manual i është përcjellë drejtorisë, dhe kjo e fundit ka dërguar komentet dhe qendrimin e saj. Në Dhjetor 2020, ky manual është finalizuar dhe i është përcjellë shtëpisë botuese për botim.

- *Postera informues në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike falas*

Në muajin Shtator 2020 u bë i mundur dizenjimi dhe printimi i mbi 500 posterave adezivë promovues të sistemit të ndihmës juridike falas me qëllim afishimin e tyre pranë institucioneve shtetërore në gjithë Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër, Drejtoria e Ndhmës ka vijuar me dërgimin e shkresave drejtuar Gjykatave; Prokurorive dhe Bashkive të Republikës së Shqipërisë për publikim të posterave në ambiente të dukshme të institucioneve. Institucionet në nivel vendor dhe qendror janë treguar mjaft bashkëpunues sa i përket afishimit të tyre.

- *Zhvillimi i trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.*

Nga ana e Euralius është shprehur mbështetja për zhvillimin e një trajnimit mbi ligjin për ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe akteve nënligjore në zbatim të tij duke përcjellë raste të praktikës shqiptare dhe të huaj. Ky trajnim u zhvillua nga ekspertët e kontraktuar nga Euralius në muajin Dhjetor 2020.

- **Bashkëpunimi me UNDP**

- *Hapja e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore.*

UNDP është një ndër partnerët kryesorë mbështetës të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me mbështetjen e të cilit përgjatë vitit 2020 janë bërë funksionale 5 (pesë) qendra të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytetin e Lezhës, Durrësit; Shkodrës; Gjirokastrës dhe Pogradecit

Siç është përcaktuar edhe në kapitullin nr. 3, me qëllim bërjen funksionale të këtyre qendrave janë ndërmarrë të gjitha procedurat sa i përket gjetjes së ambienteve të përshtatshme; rekrutimit të punonjësve të rinj si dhe pajisjes së qendrave me mjetet e nevojshme logjistike.

Mbetet objektiv, bërja funksionale me mbështetjen e UNDP të qendrës së Fierit, Vlorës dhe Dibrës brenda vitit 2021²² në kuadër dhe të hartës së re gjyqësore sipas përcaktimeve të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor”,

^{22 22} Në zbatim të neneve 91 e 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Referuar këtij vendimi, për një periudhë 4(katër) mujore përpara datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve janë të përcaktuara në mënyrë eksplicite një sërë veprimtarish/procedurash të ndaluara për t`u zhvilluar nga organet e administratës publike. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, pas analizimit të këtij akti, me shkresën me nr. 19 prot. Datë 11.01.2020, vlerësoi të nevojshme dhënien e një orientimi ligjor nga ana e KQZ, nëse veprimtaritë e planifikuara për t`u zhvilluar për 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2021 (referuar planit të punës si dhe Strategjisë 5 vjeçare për ndihmën juridike të garantuar nga shteti) konsiderohen ose jo veprimtari të ndaluara dhe konkretisht: **Veprimtaria nr. 1: Hapja e Qendrave të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore. Veprimtaria nr. 2: Financimi i OJF-të e autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike. Mbetemi në pritje të dhënies së një përgjigje nga ana e këtij institucioni.**

- ***Përgatitja e një protokollit komunikimi sa i përket mënyrën së raportimit dhe administrimit të rasteve***

Në kuadër të projekteve të përbashkëta me UNDP një ndër proceset e punës është hartimi një Protokollit Komunikimi në kuadër të Sistemit të menaxhimit të çështjeve, protokoll i cili ka për qëllim lehtësimin e punës së ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

- ***Mbështetjen në drejtim të forcimit të kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore përmes zhvillimit të trajnimeve në fusha specifike të lidhura me kategoritë vulnerabël. (cituar në kapitullin e forcimit të kapaciteteve).***
- ***Mbështetjen lidhur me promovimin e sistemit të ndihmës juridike falas përmes ndërgjegjesimit dhe informimit të qytetarëve.***

Në funksion të promovimit të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike të hapura me mbështetjen e UNDP është mundësuar hartimi dhe printimi i materialeve të vizibilitetit si: Fletëpalosje dhe postera të dedikuara për çdo qendër të cilat përmbajnë informacion të koncentruar sa i përket mënyrës së përfitimit nga shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

- Bashkëpunimi me OSFA

- ***Hapja e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore.***

OSFA është një ndër partnerët mbështetës të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me mbështetjen e të cilit përgjatë vitit 2020, ka vijuar funksionimin si qendër e shërbimit të ndihmës juridike parësore nën administrimin e DNJF, qendra të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytetin e Tiranës e ndodhur pranë ambienteve të Ministrisë së Drejtësisë.

- ***Ndjekja e procedurave në kuadër të krijimit të një Case Management System.***

DNJF ka komunikuar me përfaqësues të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë mbi sistemin elektronik të të dhënave që Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë administron. Ky sistem është implementuar në Klinikat Ligjore të hapura nga ana e OSFA përmes të cilit administrohen të dhëna për të gjitha shërbimet juridike parësore të ofruara nga këto Klinika.

Nga OSFA u theksua gadishmëria dhe bashkëpunimi për ta zhvilluar më tej këtë sistem me synimin për të përfshirë të gjitha të dhënat e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike falas, përcaktuar në ligjin 111/2017. Përfaqësuesit e OSFA u shprehën se ky sistem është i gatshëm, funksional, lehtësisht i transferueshëm me qëllim aksesimin nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe mbi të gjitha do të financohet nga OSFA në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike

parësore të hapura me mbështetjen e këtij fondacioni . Për këtë arsye, DNJF i është drejtuar shkresërisht Ministrisë të Drejtësisë për vlerësimin dhe gjykimin të çështjeve të parashtruara më lartë . Nga ana e Ministrisë të Drejtësisë është shprehur dakordësia për bërjen funksionale të sistemit të menaxhimit të çështjeve duke marrë si model sistemin e krijuar tashmë nga OSFA.

Pavarësisht këtij fakti, duke qenë se lidhur me këtë sistem kemi patur një kontribut dhe mbështetje nga të 3 organizatat mbështetëse të DNJF (UNDP, OSFA dhe Euralius), u gjykua e nevojshme mbledhja e përfaqësuesve nga të 3 organizatat e sipërpërmendura, me qëllim diskutimin mbi mënyrën se si ky sistem mund të implementohet, si mund të përmirësohet dhe çfarë mbështetje mund të ofrojë secili prej tyre. Mbetet objektiv, bërja funksionale e këtij sistemi brenda vitit 2021

- ***Ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore përmes platformës juristionline gjatë kohës së pandemisë.***

Me qëllim dhënien e ndihmës juridike parësore online për të gjithë qytetarët: Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, është duke vijuar me ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes platformës juristionline.al. Kjo platformë ka rezultuar mjaft e suksesshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre.

- ***Ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore përmes numrit të gjelbër 08001010.***

Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike parësore, DNJF me mbështetjen e OSFA, ka vendosur në dispozicion një linjë të gjelbër në të cilën kanë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosja e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. Si platforma juristionline ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime profesionale dhe me standard të lartë dhe duke qenë sa më pranë qytetarit.

Kapitulli 8

BASHKËPUNIMI ME AKTORË TË TJERË TË SISTEMIT TË DREJTËSISË

- Nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas”.

Në kuadër të zbatimit të politikave në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, DNJF, ka proceduar me hartimin e marrëveshjeve TIP të mirëkuptimit me objekt “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Kjo marrëveshje TIP ka për qëllim bashkëpunimin e aktorëve të përfshirë sipas nenit 6 të ligjit nr. 111/2017, përmes:

- Orientimit të subjekteve përfitues drejt sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017;
- Promovimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese; edukimit ligjor apo afishimit të materialeve të vizibilitetit;
- Shkëmbimit të përvojës në kuadër të përmirësimit të politikave shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- Zhvillimit të takimeve për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët;
- Kryerjes së analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore.

Kjo marrëveshje është nënshkruar me 27 Gjykata të Rrethit Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë. me objekt: “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Duke vlerësuar maksimalisht rolin që kanë Gjykatat në sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, këto marrëveshje janë një vlerë e shtuar në përmbushje të misionit të DNJF.

- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit “Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundërshpërblim për tu përdorur si qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore” me Gjykatat, Bashkitë dhe ADISA;

Në kuadër të hapjes së qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore, si një ndër objektivat kryesorë të DNJF dhe Ministrisë së Drejtësisë, DNJF ka kërkuar bashkëpunimin e ADISA-s në kuadër të vendosjes në dispozicion të ambjentëve pa kundërshpërblim për tu përdorur

si qendra shërbimi. Nga ana e ADISA-s është treguar angazhimi maksimal përmes nënshkrimit të një Marrëveshje Bashkëpunimi me nr. 632 prot., datë 19.12.2020 nëpërmjet të cilës ADISA garanton vendosjen në dispozicion të ambjenteve pranë qendrave të integruara ADISA në rrethe. Duke marrë parasysh natyrën e shërbimeve më një ndalesë që ADISA ofron, pozicionimi i qendrave në këto ambiente do të mundësojë një akses të shtuar për qytetarët.

- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Organizatën e autorizuar ALTRI.

Nga ana e ALTRI-t na është përcjellë projekti, *“Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit në Shqipëri nëpërmjet advokimit për ndërmarrjen e masave konkrete dhe ofrimit të modeleve të suksesshme”*, në të cilin janë evidentuar disa problematika sa i përket:

- Nivelit të ulët të njohurive të qytetarëve lidhur me ndërmjetësimin;
- Mungesës në dhënien e informacionit nga gjykatat lidhur me këtë institut;
- Mungesës së masave lehtësuese për grupet vulnerabël sa i përket tarifave të ndërmjetësimit.

Ky projekt është duke u financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe ka si aktivitete kryesore:

- Nxitjen e qytetarëve drejt zgjidhjes së institutit të ndërmjetësimit nëpërmjet bashkëpunimit me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore Tiranë; Durrës; Fier dhe Pogradec përmes caktimit të një eksperti ndërmjetës të mbështetur financiarisht nga ALTRI pranë këtyre qendrave (për një periudhë kohore 6 mujore);
- Ofrimin e modeleve të shërbimit të ndërmjetësimit falas për kategoritë në nevojë nëpërmjet klinikave të ligjit;
- Promovimin e sistemit të ndërmjetësimit përmes platformës juristonline në një gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme;
- Advokimin për ndryshime ligjore apo gjetjen e mekanizmave që synojnë përmirësimin e shërbimit të ndërmjetësimit sipas rekomandimeve të evidentuara në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.

Sa më sipër, në kushtet kur bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, Klinikat Ligjore dhe organizatat jofitimprurëse përveç se është një detyrim ligjor i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, referuar nenit 8 shkronja “c” të ligjit nr. 111/2017, është edhe një masë e rëndësishme në kuadër të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut, si një element thelbësor në funksion të garantimit të aksesit në drejtësi, DNJF është shprehur e gatshme të bashkëpunojë në kuadër të përmbushjes së rezultateve të pritshme të këtij projekti.

- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Organizatën Drejtësi Sociale.

Në muajin Dhjetor 2020 u bë i mundur Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Organizatën Drejtësi Sociale.

Objekti i kësaj marrëveshje mes Palëve konsiston në vendosjen e bashkëpunimit sa i përket shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti me qëllim ndërmarrjen e masave për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve dhe në veçanti të grupeve vulnerabël.

Palët bien dakord të bashkëpunojnë mbi:

- Promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese ; edukimit ligjor apo afishimit të materialeve të vizibilitetit;
- Shkëmbimin e përvojës në kuadër të përmirësimit të politikave shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- Zhvillimin e takimeve për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët;
- Planifikimin dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta në këtë kuadër;
- Kryerjen e analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore.
- Krijimin nga ana e organizatës të hapsirave të nevojshme në lidhje me publicitetin e ndihmës juridike falas që ofrohet për shtresat në nevojë.
- Informimin periodikisht nga ana e DNJF, të organizatës në lidhje me aktet e dala në funksion të ligjit.

Kapitulli 9

ZHVILLIMI I FUSHATAVE PËR RRTJEN E NDËRGJEGJËSIMIT PUBLIK MBI OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE DHE EDUKIMIN LIGJOR TË PUBLIKUT

Duke qenë tërësisht të vetëdijshëm se rritja e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitim të saj përveçse një detyrimi ligjor (neni 8 i ligjit 111/2017), është një nga komponentët me thelbësorë të funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dhe forcimit të aksesit të qytetarëve në drejtësi, DNJF i ka kushtuar një vemëndje të shtuar informimit mbi sistemin e ndihmës juridike falas duke u ndalur në hartimin dhe publikimin e materialeve të vizibilitetit si dhe publikimit të postimeve/videove ndërgjegjëse në rrjetet sociale të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

1. Zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të forcimit të sistemit të ndihmës juridike parësore.

- *Takim me punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore*

Pranë ambjenteve të Ministrisë së Drejtësisë, me prezencën e Ministres së Drejtësisë, zj. Etilda Gjonaj u zhvillua më datë 01.09.2020, një takim pune me punonjësit me trajnim të posaçëm në Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas në Tiranë, Durrës, Fier dhe Lezhë.

Në këtë takim ju kushtua një rëndësi e veçantë diskutimit mbi mënyrat e sensibilizimit të qytetarëve dhe nxitjen e tyre për të marrë shërbimin ligjor falas pranë këtyre qendrave.

- *Aktivitet Ndërgjegjësues "Aksesi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin", Kavajë, 09 Mars 2020*

Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve është një nga parimet më thelemore të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Formë e mbrojtjes së këtij interesi është edhe aksesit në drejtësi për të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin duke garantuar një shërbim ligjor falas dhe cilësor. Nga ky këndvështrim, ishte e nevojshme të bëheshin ndryshime ligjore në legjislacionin e procedurës penale dhe gjithashtu në ligjin "Për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti".

Ligji 111/2017, "Për Ndihmën Juridike të garantuar nga Shteti", në referim të nenit 11 të tij, tashmë i ka cilësuar të miturit si subjekte të posaçëm të cilët, pavarësisht nga të ardhurat e tyre janë përfitues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Konkretisht, fëmijët që jetojnë në institucione të kujdesit shoqëror; fëmijët në kujdestari, të cilët kërkojnë të fillojnë një proces pa pëlqimin e përfaqësuesit të tyre ligjor ose kundër përfaqësuesit të tyre ligjor; viktimat mitur dhe të miturit në kundërshtim me ligjin, në çdo fazë të procedurës penale (për të cilën nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme), mund të përfitojnë që nga këshillimi ligjor (ndihma juridike parësore) deri në përfaqësimin e çështjeve në gjykatë (ndihmë juridike sekondare).

Gjithashtu, duke ritheksuar edhe njëherë mbrojtjen e interesave më të lartë të fëmijëve, është detyrim ligjor që juristët/avokatët që ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike falas, të jenë të specializuar në sistemin e Drejtësisë për të mitur përmes ndjekjes së trajnimeve fillestare dhe të

vazhdueshme të organizuara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas/Departamenti i Administratës Publike/ Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Pavarësisht lehtësirave që ka sjellë ky ligj në kuadër të përfitimit të shërbimit ligjor falas, vihet re se nga të miturit apo familjarët e tyre, nuk ka kërkesa për përftim të ndihmës ligjore falas. Kjo mund të jetë si shkak i mungesës së informacionit mbi këtë shërbim . Në këto kushte, nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është planifikuar zhvillimi i një sërë aktiviteteve ndërgjegjëse duke u ndalur veçanërisht tek kategoritë e veçanta të ligjit.

Pjesë e këtyre aktiviteteve ishte dhe Aktiviteti “*Aksesi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin*” i cili u zhvillua me qëllim ndërgjegjësimin e të miturve pranë Qendrës së Re-Integrimit të të Miturve Kavajë.

Ky aktivitet u zhvillua në 3 seksione ku përfaqësuesit e ndihmës juridike falas patën mundësinë të bashkëbisedonin me të miturit e kësaj qendre duke i shpjeguar në mënyrë të thjeshtëzuar se si ata apo prindërit e tyre mund të përfitonin nga shërbimet ligjore falas.

Të miturit gjatë takimit informues u shfaqën mjaft të interesuar për t’u informuar mbi mënyrën e përfitimit të këtij shërbimi. Shumica prej tyre i shprehën problematikat ligjore më të cilat përballen familjarët e tyre të cilat lidheshin më së tepërmi me “detyrimin për ushqim” si dhe me kërkesat për “revokimin e avokatëve të caktuar kryesisht”.

Me qëllim zgjidhjen e këtyre problematikave dhe përfitimin e shërbimit nga këta të mitur, përfaqësuesit e DNJF shkëmbyen kontaktet me Punonjësit Socialë të Qendrës së Re-Integrimit të të Miturve Kavajë të cilët ishin mëse të gatshëm për bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas në trajtimin e këtyre rasteve.

- *Tryezë e Përbashkët në kuadër të promovimit dhe nxitjes së sistemit të ndihmës juridike falas, Elbasan 05 Mars 2020*

Më datë 5 Mars DNJF me zhvilloi një tryezë të përbashkët me përfaqësues nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Bashkia Elbasan, Drejtoria e Policisë Vendore dhe përfaqësues të Organizatave Jofitimprurëse. Qëllimi i kesaj tryeze konsistonte në rëndesine dhe efikasitetin që duhet te ketë Sistemi i Ndhmës Juridike Paresore dhe fokusin për te rritur urat e bashkëpunimit nderinstitucional në mënyrë të tillë që çdo qytetari t’i garantohet akses në Drejteësi. Tryeza rezultoi mjaft frytdhënëse në kuadër të lidhjes së urave të bashkëpunimit me aktorët ndër institucionalë.

- *Intervista televizive me qëllim përcjelljen e njohurive mbi sistemin e ndihmës juridike falas tek qytetarët*

Më datë **17 qershor 2020**²³, 2 specialistë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas janë ftuar në emisionin “Mirmëngjes Shqipëri” në Radio Televizionin Shqiptar gjatë të cilit është diskutuar mbi

²³ Linku i intervistës: <https://youtu.be/tv-4ëtNcODg>

ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas gjatë periudhës së pandemisë, sistemin e ndihmës juridike falas, ofruesit e këtij shërbimi dhe kategoritë përfituese.

Në **muajin Nëntor të vitit 2020** është realizuar intervista televizive me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec dhe kryetarit të Dhomës Vendore të Avokatisë Korçë në të cilën është folur mbi sistemin e ri të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, kushtet e përfitimit, ofruesit e shërbimit dhe informacione të tjera të nevojshme për informimin ligjor të publikut.

Këto intervista kanë vijuar të zhvillohen përgjatë muajit dhjetor me qëllim përmbushjen e objektivit të DNJF lidhur me promovimin e sistemit të ndihmës juridike falas dhe edukimin ligjor të publikut.

- *Takim me organizatat jofitimprurëse të autorizuara që do të ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti.*

Më datë 10.09.2020, u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së autorizimeve nga ana e Ministrit të Drejtësisë të 12 organizatave jofitimprurëse të autorizuara me një shtrirje gjeografike në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër dhe Berat. Gjatë këtij takimi u vu theksi në prioritetin që i jepet ndihmës juridike falas, në realizimin e së cilit kanë qenë mbështetës aktorët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile. Organizatat jofitimprurëse krahas Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Klinikave të Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë, përmes eksperiencës së tyre shumëvjeçare do të sigurojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas tek qytetarët në mënyrë profesionale dhe cilësore, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

- *Takim prezantues i dy akteve të fundit nënligjore të miratuara për Ndhmën Juridike Falas.*

Në kuadër të hyrjes në fuqi të akteve nënligjore mbi tarifën dhe rotacionin e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore u zhvillua një aktivitet prezantues më datë 16.09.2020, me pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë; përfaqësuesve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore; Dhomave Vendore të Avokatisë, Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë si dhe ekspertëve të fushës. Këto akte përcaktojnë rregulla të hollësishme për përgatitjen e listave dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore për qytetarët në proceset civile dhe administrative në zbatim të parimit të rotacionit, si dhe kriteret dhe tarifën për këtë shërbim. Normimi i parimit të rotacionit siguron një proces gjithëpërfshirës, transparent dhe më efektiv në përzgjedhjen e avokatëve që do të përmirësojë edhe shërbimin e ndihmës juridike dytësore për qytetarët në tërësi.

- *Publikime dhe produkte të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në kuadër të vizibilitetit.*

Publikimi i manualit “Si të përfitojmë ndihmë juridike falas”

DNJF në kuadër të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 8 shkronja “d” dhe “e” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ka vijuar me hartimin dhe publikimin e një manuali të thjeshtëzuar mbi kriteret dhe procedurën e përfitimit nga shërbimet e ndihmës

juridike falas. Manuali për ndihmën juridike u është përcjellë disa institucioneve si Bashkia Tiranë, Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Kryeministrisë në kuadër të nxitjes dhe bashkëpunimit .

- *Promovimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore përmes vendosjes së posterave pranë institucioneve kryesore në vend.*

DNJF në kuadër të përmbushjes së këtij aktiviteti, ka zhvilluar një sërë takimesh me EURALIUS V19 sa i përket përmbajtjes së posterave. Në muajin Shtator 2020 u bë i mundur dizejnimi dhe printimi i mbi 500 posterave adezivë promovues të sistemit të ndihmës juridike falas me qëllim afishimin e tyre pranë institucioneve shtetërorë në gjithë Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, janë hartuar dhe vendosur në dispozicion të qytetarëve fletëpalosje të dedikuara për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat DNJF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

- *Përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare²⁴ në kuadër të transparencës dhe informimit të qytetarëve.*

Që prej muajit Mars 2020, është finalizuar faqja zyrtare e DNJF dhe është vendosur në dispozicion të publikut. Aktualisht DNJF është duke e përditësuar faqen në mënyrë aktive përmes publikimit të raportimeve të ndryshme në kuadër të transparencës si dhe manualeve në ndihmë të qytetarëve për përfitimin e shërbimit.

- *Promovimi i sistemit të shërbimit të ndihmës juridike falas përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram.*

Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur ngushtësisht me qytetarët dhe duke marrë parasysh faktin se ky shërbim është relativisht i ri dhe i panjohur për të shumtën e qytetarëve, DNJF është duke punuar në mënyrë të vazhdueshme për promovimin e këtij sistemi përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram të cilat janë mjaft të përdorshme nga qytetarët. Kemi vijuar me postime të vazhdueshme informative mbi procedurat që duhen ndjekur për përfitimin e këtij shërbimi si dhe janë mbajtur komunikime të vazhdueshme me qytetarët të cilët na janë drejtuar për të kërkuar informacion.

- *Përfshirja e sistemit të ndihmës juridike falas si E-shërbim në platformën E-albania.*

Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur ngushtësisht me qytetarët, promovimi dhe informimi mbi këtë sistem është një element kyç në kuadër të rritjes së aksesit të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë. Si një mjet mjaft i mirë në kuadër të përmbushjes së këtij qëllimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas me shkresën me nr. 371 prot., datë 23.09.2020 i ka propozuar Ministrië së Drejtësisë dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, përfshirjen e ndihmës juridike falas si E-shërbim në Platformën E-ALBANIA. Kjo platformë, sidomos periudhën aktuale për shkak të pandemisë Covid-19, ka një përdorim mjaft të gjerë ndaj edhe përfshirja e E-shërbimit “Ndihmë juridike falas” do të ketë një impakt në rritjen e nivelit të

²⁴ <https://ndihmajuridike.gov.al/>

informacionit të qytetarëve mbi këtë sistem. Që prej datës 17 Dhjetor 2020, Të gjithë shtetasit tashmë mund të përfitojnë shërbimet e këshillimit ligjor direkt nga *e-albania* bashkë me të gjitha shërbimet e tjera online²⁵.

- *Platforma e katërt Kombëtare për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri.*

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas mori pjesë në Platformën e katërt Kombëtare për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri e cila u mbajt online në datë 29 Shtator 2020, organizuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal Ekipi i Veprimit për Integrimin e Romëve, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në këtë takim, u prezantua “Raporti mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri, për vitin 2019” dhe u diskutuan politikat kombëtare dhe prioritetet për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në fushat kryesore, pjesë e së cilave ishin edhe masat dhe indikatorët të cilat janë nën fushën e përgjegjësisë së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

- *Inagurimi i Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec, Tetor 2020.*

Qytetarët që përfitojnë janë ata në pamundësi financiare për të marrë një avokat, qoftë për t’u këshilluar, për t’u përfaqësuar në gjykatë apo për të përgatitur dokumentat për përfaqësim në gjykatë, apo për të ditur kujt t’i drejtohen. Gjithashtu, shërbimet e ndihmës juridike falas ofrohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë për grupet vulnerabel / kategoritë e veçanta të ligjit si: gratë viktime të dhunës në familje, viktime të trafikimit, të miturit, grupet në nevojë, grupet që i përkasin komuniteteve apo pakicave kombëtare etj.

- *Webinar mbi procedurën e administrimit të të dhënave dhe raportimit nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore”, Tetor 2020.*

Qëllimi kryesor i këtij webinar ishte diskutimi në terma teknikë dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit në kuadër të rasteve të trajtuara, mbajtjes të të dhënave dhe administrimit të tyre sipas formateve të reja të përcaktuara nga aktet nënligjore.

Janë pikërisht këto të dhëna, të administruara nga të gjithë ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike të cilat do të shërbejnë për hartimin e politikave të ndryshme në këtë kuadër si dhe do të jenë një indicie për evidentimin e nevojave për ndryshime ligjore.

- *Takim Online me Klinikat e Ligjit, Tetor 2020.*

Më datë 28.10.2020 u zhvillua takimi i parë teknik me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me të cilat Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

Gjatë këtij takimi u diskutua për rolin që u është atribuar me ligj Klinikave të Ligjit, si ofrues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike falas dhe masat që duhen ndërmarrë me qëllim vendosjen e tyre

²⁵ https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=787&service_type=N

në të njëjtën linjë me Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara.

Pavarësisht se ndodhemi në kushtet e një viti të ri akademik sfidues, referuar masave kufizuese të ndërmarra për shkak të pandemisë, nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe përfaqësuesve të Klinikave u shpreh angazhimi maksimal dhe gadishmëria për bashkëpunim të mëtejshëm.

- *Webinar mbi Standardet e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes së cilësisë” Nëntor 2020.*

Qëllimi kryesor i këtij webinarit ishte diskutimi në terma teknike dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore në kuadër të standardeve të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes së cilësisë.

Diskutimi u përqëndrua në disa tematika kryesore si: Risitë e ligjit nr.111/2017, në kuadër të mekanizimit të mbikëqyrjes së cilësisë; Standardet e reja dhe indikatorët e vlerësimit të sanksionuara në Metodologjinë e miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë dhe zbatimi në praktikë referuar problematikave të nxjerra nga monitorimet e kryera.

- *Takim me Shoqatën “Unë, Gruaja” Nëntor 2020.*

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas, si një nga aktorët mbështetës për projektin “Ligji është jetë – Mbrojeni jetën tuaj!” mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Shoqata Shoqata Une, Gruaja për Vullnetarët e Ligjit me temë: “Rritja e kapaciteteve për grupet mbështetëse në lidhje me informacionin ligjor për publikun dhe qasjen e tij në drejtësi”.

Ky trajnim u organizua në kuadër të projektit: “Ligji është jetë- Mbrojeni jetën tuaj!” i cili po zbatohet nga Shoqata “Unë, Gruaja” në Korçë dhe Pogradec me mbështetjen UNDP Albania dhe fonde të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

Projekti “Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri” zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Ministria e Drejtësisë dhe financim të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA)”

- *Trajnimi ne webinar i stafit të Dnjf me Euralius V, Dhjetor 2020.*

Stafi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe i Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në datë 10.12.2020 u angazhua në trajnimin e organizuar nga Euralius V mbi ligjin “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” me pjesëmarrjen e Z. Thomas Traar dhe Zj. Arta Vorpsi.

Stafi diskutoi mbi arritjet e deritanishme dhe problematikat e hasura në praktikë nga kuadri ligjor i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

- *Afishimi i posterit “Ke nevojë për ndihmë juridike”, në ambientet e pushtetit qendror, lokal dhe sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, Dhjetor 2020.*

Në përmbushje të misionit madhor të Ministrisë së Drejtësisë, garantimit të aksesit në drejtësi për çdo qytetar, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e qeverisjes e nivelit qëndror, lokal dhe sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka vijuar me komunikimet me qëllim promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit tek qytetarët në lidhje me sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti duke kërkuar nga institucionet shtetërore afishimin e posterave “Ke nevojë për ndihmë juridike”.

Këto postera janë konceptuar nga Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me Euralius V, ku platforma jurstionline.al dhe numri i gjelbër 0801010 janë financuar nga “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” dhe kanë për qëllim kryesor ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe orientimin e tyre drejt sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, si element thelbësor i aksesit në drejtësi.

- *Nënshkrimi i 27 marrëveshjeve “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” me Gjykatat e Republikës së Shqipërisë, Dhjetor 2020.*

Në përmbushje të misionit madhor të Ministrisë së Drejtësisë, “Sigurimit të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive, për të gjithë kategoritë përfituese”, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka nënshkruar 25 marrëveshje me Gjykatat e Republikës së Shqipërisë me objekt :“Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Duke vlerësuar maksimalisht rolin që kanë Gjykatat në sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, këto marrëveshje janë një vlerë e shtuar në përmbushje të misionit të DNJF.

2. Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit

- *Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Fierit, Nëntor 2020.*

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas po vijon me promovimin e shërbimit për qytetarët, si edhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit të shtetasve mbi shërbimin juridik falas.

Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF ishte në qytetin e Fierit ku organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u afishuan postera të ndihmës juridike në institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; Prokuroria; Bashkia; Shtëpia e të moshuarve; ADISA.. etj si dhe u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.

- *Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Lezhës, Nëntor 2020.*

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas po vijon me promovimin e shërbimit për qytetarët, si edhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit të shtetasve mbi shërbimin juridik falas.

Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF ishte në qytetin e Lezhës ku organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u afishuan postera të ndihmës juridike në institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Prokuroria; Bashkia; etj si dhe u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.

- *Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Tiranës, Nëntor 2020.*

Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.

- *Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Durrësit, Dhjetor 2020.*

Gjatë muajit dhjetor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.

- *Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Shkodrës, Dhjetor 2020.*

Gjatë muajit dhjetor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.

- *Takim informues me qytetarë të komunitetit Romë dhe Egjiptian në Shkozë, Tiranë mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Nëntor 2020.*

Ekipi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas organizoi një takim me qytetarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian në zonën e Shkozës, Tiranë, bashkë me përfaqësuesit e Klinikës Ligjore Wisdom, me të cilët është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi.

Pjesëmarrësit, si një ndër kategoritë përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, u informuan mbi të drejtat që ligji për ndihmën juridike u garanton dhe mënyrën e përfitimit të ndihmës juridike falas.

U zhvillua një bashkëbisedim mbi problematikat ligjore të qytetarëve, të cilat do të adresohen për t'u trajtuar në Klinikën e Ligjit Wisdom dhe Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë.

Kapitulli 10

ANGAZHIMET STRATEGJIKE TË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

1. Angazhim i DNJF në kuadër të **Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP)**²⁶; *(Ndjekja e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në strategji dhe plan veprimi me qëllim përmbushjen e objektivave të parashikuar për ndihmën juridike).*

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, është një instrument i rëndësishëm me fokus parashikimin e masave konkrete mbi informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve. Është pikërisht Plani i Veprimit në zbatim të kësaj strategjie, dokumenti në të cilin përmbledhen të gjitha aktivitetet dhe masat në përmbushje të objektivave strategjike. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është një nga institucionet e përfshira në këtë plan masash.

Në këtë plan janë parashikuar disa masa konkrete që synojnë të mbështesin dhe informojnë komunitetet rome dhe egjiptiane në përputhje me nevojat e tyre. Konkretisht, DNJF ndër të tjera, është përgjegjëse për masat nën objektivat si vijon:

Objektivi Specifik 2.3: Konkretizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional nëpërmjet realizimit të iniciativave të përbashkëta të ELP-së.

2.3.2 Instrumentet për veprimtaritë dhe bashkëpunimin në fushën e ndihmës juridike falas në nivel qendror dhe nivel vendor, të përmirësuara.

2.3.2 a Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me OSHC-të, Klinikave të Ligjit për ofrimin e ndihmës juridike falas (kontrata bashkëpunimi).

Zhvillimet kryesore të DNJF:

- ✚ Janë nënshkruar Marrëveshjet e Bashkëpunimit me 9 Klinika Ligji pranë IAL-ve (UET, FDUT, Wisdom, Qirjazi, Aleksandër Mojsiu, Beder, Shkodra dhe Mesdhetari);
- ✚ Takim me të gjitha Klinikat e Ligjit (tetor 2020).

2.3.4 Iniciativat e përbashkëta midis OSHC-ve/klinikave të ligjit dhe organit që administron ndihmën juridike falas/DNJF të zhvilluara.

2.3.4 a Fushata sensibilizimi mbi ligjin për ndihmën juridike falas (fletëpalosje/takime/aktivitete përbashkëta institucionale): Mars 2020: zhvillimi i një fushate ndërgjegjëse me aktorët e

²⁶ *Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, është një instrument i rëndësishëm me fokus parashikimin e masave konkrete mbi informimin ligjor dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve. Është pikërisht Plani i Veprimit në zbatim të kësaj strategjie, dokumenti në të cilin përmbledhen të gjitha aktivitetet dhe masat në përmbushje të objektivave strategjike. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është një nga institucionet e përfshira në këtë plan masash.*

shoqërisë civile/institucionet publike në qytetin e Elbasanit (aktivitete në vijimësi gjatë kohës së zbatimit të këtij PV);

2.3.4 b Realizimi i iniciativave të përbashkëta midis OSHC-ve/klinikave të ligjit dhe DNJF: 3 tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të MD (Dr. Ndhmës Juridike Falas) - 6M II 2020: Aktivitet në kuadër të bashkëpunimit me klinikat e ligjit pranë IAL-ve, pas nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit;

2.3.4 c Përgatitja e kurrikulës së veçantë të trajnimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti bazuar në kërkesat dhe kategoritë e grupeve vulnerabël, të ligjit të ndihmës juridike dhe ligjit për profesionin e avokatit.

Zhvillimet kryesore të DNJF:

- ✚ Është zhvilluar në Mars 2020: zhvillimi i një fushate ndërgjegjëse me aktorët e shoqërisë civile/institucionet publike në qytetin e Elbasanit;
- ✚ Tryeza me: Klinikat e Ligjit; Qendrat e NJP; OJF e autorizuar (Shtator – Tetor 2020);
- ✚ Trajnimi i Avokatëve (është hartuar kurrikula e trajnimit);
- ✚ Webinare: (me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike në kuadër të administrimit të të dhenave dhe politikave dhe procesit të mbikëqyrjes).

Objektivi specifik 4.1: Rritja e aksesit të publikut në informacionin ligjor dhe pasurimi i vazhdueshëm i njohurive juridike të tyre në përputhje me nevojat specifike.

4.1.1 Hartimi i materialeve që fokusohen në tema të veçanta ligjore dhe/ose me interes për grupe të qytetarëve me nevoja të veçanta, në formate të përshtatshme lehtësisht të aksesueshme.

4.1.1 a Vlerësim mbi nevojat prioritare dhe imediate të qytetarëve për ELP-të(I) Identifikimi i autoriteteve kryesore qendrore dhe vendore të cilat duhet të përmbledhin informacion ligjor në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun, sipas fushës së tyre të veprimtarisë (II) Mars 2020: Aktivitet ndërgjegjëses/sesion informues mbi sistemin e ndihmës juridike falas për të miturit në Institutin e të Miturve Kavajë (përgatitje fletëpalosjesh, broshura informuese dhe manual mbi sistemin e ndihmës juridike në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme) - Brenda vitit 2020: zhvillimi i aktiviteteve/sesioneve të informimit në gjimnaze, duke filluar me qytetin e Elbasani, aty ku është ngritur qendra e ofrimit të ndihmës juridike e duke vijuar me qytetin e Tiranës. (përgatitje e materialeve në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme). Aktivitet ndërgjegjëses mbi sistemin e ndihmës juridike falas për gratë e dënuara.

4.1.1 b Hartimi i materialeve informuese alternative me grafika, simbole dhe shenja të përshtatura me kategoritë e përfituesve dhe aftësitë e tyre për marrjen e informacionit. Aktivitete që vijnë në përputhje me kohën e zbatimit të PV.

Zhvillimet kryesore të DNJF:

- ✚ Afishimi i posterave informues në të gjitha gjykatat, bashkitë dhe institucionet e tjera;
- ✚ Shpërndarja e fletëpalosjeve mbi ndihmën juridike në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimin;

- ✚ Publikimi dhe shpërndarja e manualit të thjeshtëzuar me informacion të koncentruar si të përfitojmë nga sistemi i ndihmës juridike falas.
- ✚ Postera, fletëpalosje specifike për Klinikat e Ligjit.
- ✚ Në proces, hartimi i manualeve specifike për çdo kategori të veçantë.

4.1.3 Mekanizma për të përmirësuar bashkëpunimin e vazhdueshëm me median

4.1.3 b Realizimi i programacioneve mediatike/ intervistave dhe diskutimeve në TV kombëtare dhe lokale, si dhe në radio nga anëtarët e Rrjetit me tematika të ndryshme ligjore sipas sektorëve përkatës (nr. i programeve RTV me tematika ELP

Objektivi specifik 4.2: Informimi dhe ndërgjegjësimi i gjerë i publikut nëpërmjet fushatave mediatike në një fushë ligjore të caktuar apo në trajtimin ligjor të një fenomeni specifik.

4.2.1 Mekanizma dhe instrumente të lidhura me informimin dhe ndërgjegjësimin publik, të përmirësuar.

4.2.1 c Fushata ndërgjegjësuese dhe informuese për ligjin nr.111/2017; broshura dhe fletëpalosje specifike në qytete Tiranë, Durrës, Elbasan, etj) Aktivitete që kryhen në vijimësi gjatë viteve të zbatimit të PV;

4.2.1 ç Forume të hapura me pjesëmarrje të gjerë qytetare me qëllim marrjen e njohurive ligjore mbi ligjin nr.111/2017, sistemin e ndihmës juridike falas, kushtet/kriteret e përfitimit/subjektet përfitues/shërbimet që ofrohen etj. Aktivitete që kryhen në vijimësi gjatë viteve të zbatimit të PV.

Zhvillimet kryesore të DNJF:

- ✚ Intervistë e zhvilluar në Qershor 2020 stafi i DNJF dhe Nëntor 2020 nga punonjësit e qendrës Pogradec.
- ✚ Fushata sensibilizuese në Tiranë, Lezhë, Durrës, Fier dhe Shkodër ku janë funksionale qendrat e shërbimit të NJP.

Objektivi specifik 4.6: Rritja e pjesëmarrjes dhe rolit të studentëve të drejtësisë dhe profesionistëve të së drejtës në ELP.

4.6.1 Qytetarët të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore, nëpërmjet aktiviteteve me studentë të ligjit dhe avokatë të specializuar.

4.6.1 a: Aktivitete të zhvilluara me studentë të shkencave të komunikimit për të ofruar ELP pranë komuniteteve.

- ✚ Bashkëpunimi që DNJF ka me Klinikat e Ligjit përfshin të gjithë studentët dhe i angazhon ata qoftë në ofrim të shërbimit të ndihmës juridike dhe informim të qytetarëve; në hartimin e materialeve të vizibilitetit si dhe në trajnime të ndryshme që janë parashikuar.
- ✚ Për shkak të situatës së pandemisë, në kushtet kur Universitetet po funksionojnë online, zhillimi i aktiviteteve është pezulluar. Por studentët janë përfshirë në takimet online që DNJF ka zhvilluar.

2. Angazhim i DNJF në kuadër të **Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND)**; (*Ndjekja e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në strategji dhe plan veprimi me qëllim përmbushjen e objektivave të parashikuar për ndihmën juridike; kontribut i vazhdueshëm në kuadër të monitorimit të strategjisë dhe planit të veprimit të SND*).

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është një nga institucionet që garanton aksesin në drejtësi dhe si e tillë ka një kontribut të rëndësishëm në këtë strategji dhe në zbatimin e saj përmes planit të veprimit. Gjatë kësaj periudhe DNJF është angazhuar në raportim mbi masat e parashikuara në planin aktual të veprimit në zbatim të kësaj strategjie si dhe me kontribut e sugjerime konkrete mbi procesin e rishikimit të strategjisë që pritet të fillojë së shpejti. Konkretisht, kemi dhënë sugjerime pa filluar ende procesi, ndalur konkretisht si vijon: *Duke qënë një institucion kyç lidhur me aksesin në drejtësi, përfshirja e këtij institucioni duhet të konkretizohet në një objektiv strategjik të strategjisë. Në planin aktual DNJF është përgjegjës për një nën-objektiv që lidhet me aksesin në drejtësi, i cili është pjesë e objektivit 3 të strategjisë. Tashmë, me rishikimin e këtij dokumenti, mund të ndiqet e njëjta logjikë e ndarjes në nën-objektiva dhe të parashikohen në vetë strategjinë si të tillë jo vetëm në plan veprim ose mund të ndiqet logjika e rishikimit të objektivave dhe rikonceptimit e rigrupimit të tyre duke marrë parasysh edhe shtim të ndonjë objektivit tjetër nëse shikohet e nevojshme.*

3. Angazhim i DNJF në kuadër të **Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK)**; (*Kontribut i vazhdueshëm në kuadër të monitorimit të strategjisë dhe planit të veprimit të SNKK*).

DNJF ka dhënë kontribut në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të strategjisë, konkretisht për masën e lidhur me veprimtarinë Task Forcës Antikorrupsion (nën objektivin A.8 të strategjisë). Për DNJF është caktuar një person përgjegjës që do të ndjekë zhvillimet dhe kontributet në këtë kuadër.

Gjithashtu, në kuadër të Planit të Veprimit Antikorrupsion, DNJF është angazhuar dhe jep kontribut në kuadër të objektivave A8 dhe A9 lidhur me analizat e vlerësimit të riskut dhe hartimin e Planeve të Integritetit.

Planit i parë i Integritetit është hartuar dhe miratuar nga Ministri i Drejtësisë në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Antikorrupsion dhe do të shërbëjë si një model për të gjitha institucionet e linjës si dhe varësitë e tyre.

Në këtë kuadër, DNJF do të caktojë një grup pune i cili do të ndjekë hartimin dhe implementimin e Planit të Integritetit të institucionit. Procesi do të kalojë nëpër disa faza dhe do të karakterizohet nga një fazë takimesh konsultuese me aktorët e përfshirë në sistemin e ndihmës juridike, përfaqësues nga shoqëria civile, gjykatat, prokuroritë, Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë dhe në fund do të dërgohet për mendim dhe miratim Ministrin të Drejtësisë në cilësinë e institucionit epror.

3. Angazhim i DNJF në kuadër të **Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit (SDM)**; *Ndjekja e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në strategji dhe plan veprimi me qëllim përmbushjen e objektivave të parashikuar për ndihmën juridike; kontribut i vazhdueshëm në kuadër të monitorimit të strategjisë dhe planit të veprimit të SDM.*

Qëllimi i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit 2017-2020 në Republikën e Shqipërisë është promovimi dhe mbrojtja më efektive e të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktime, dëshmitar të veprave penale, të miturit nën moshë për tu ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore administrative apo civile, nëpërmjet implementimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të së drejtave të fëmijëve.

Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” i ka parashikuar të miturit si kategori të veçanta përfituese. Siç paraqitet në aspektin penal, si në çështjet civile ashtu edhe në atë administrative, të miturit në konflikt me ligjin garantohej nga një numër i të drejtave procedurale dhe garancive sipas parashikimeve të ligjit nr. 111/2017.

4. Angazhim i DNJF në kuadër të **Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025.**

Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve është një dokument i hartuar nga qeveria shqiptare nën koordinimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky Plan targeton dy komunitetet përkatëse Romët dhe Egjiptianët.

Në fund të muajit nëntor 2020 kanë nisur takimet konsultative (virtuale) në kuadër të fillimit të procesit të konsultimeve për hartimin e Planit të ri të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025 .

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar disa takime teknike pune, gjatë të cilave është diskutuar mbi objektivat dhe prioritetet e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas për fushën e Regjistrimit Civil dhe Aksesin në Drejtësi. Në mënyrë të vazhdueshme janë dhënë kontribut me komente në funksion të këtij dokumenti.

Kapitulli 11

ANGAZHIMET E DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN DHE RAPORTIMEVE NDËRKOMBËTARE

DNJF si një institucion i dedikuar sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, është angazhuar që prej fillimit të funksionimit në hartimin e kontributeve të vazhdueshme në kuadër të proceseve që ndiqen me Bashkimin Evropian. Një komponent shumë i rëndësishëm kur flitet për reformën në drejtësi dhe hapat e ndjekura nga Shqipëria në kuadër të procesit të integrimit evropian është aksesimi në drejtësi, garantimi i qasjes së barabartë për të gjithë shtetasit. Në këtë kuadër, dhe duke patur në vëmendje të veçantë rëndësinë që ka çdo kontribut i ofruar në këtë drejtim nga çdo institucion publik, është shumë i rëndësishëm që për Shqipërinë, më në fund të çelen negociatat me BE. DNJF është angazhuar maksimalisht në përcjellje të çdo kontributi, përditësimi mbi zhvillimet më të fundit dhe të çdo të dhëne statistikore të kërkuar.

1. Kontribut dhe raportime në kuadër të procesit të Integrimit Evropian për progresin e arritur mbi forcimin e aksesit në drejtësi dhe shërbimet ligjore falas:

- Kontributit i Qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë (komponenti i ndihmës juridike);
- Kontribut në kuadër të Nën – Komitetit, “Drejtësi, Liri dhe Siguri”;
- Kontribute të tjera të kërkuara në kuadër të progresit të bërë (të dhëna statistikore);
- Kontribut mbi procesin e përafrimit të legjislacionit me Acquis e BE;
- Kontribut në kuadër të takimit të Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian me temë: “Progresi i realizuar dhe sfidat në kuadër të Kriterit Politik, Kapitullit 23 dhe 24, me fokusin në 15 pikat e Vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 25 Mars 2020 për hapjen e Negociatave”;

2. Raportime ndërkombëtare:

- Kontribut i përditësuar i DNJF lidhur me **zbatimin e Konventës së OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” CEDAW**

Materiali **përmban pikat kryesore** që lidhen me përmbushjen e rekomandimeve që rrjedhin nga kjo Konventë për ndihmën juridike falas, konkretisht:

Ndihma juridike parësore (*Informacioni më i fundit sa i përket qendrave funksionale dhe ato që pritet të hapen brenda këtij viti, Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve dhe është shtuar Autorizimi i OJF-ve që do të jenë ofrues shërbimi të ndihmës juridike parësore ku një fakt shumë i rëndësishëm në këtë kuadër që lidhet direkt me rekomandimet e Konventës është autorizimi i disa OJF-ve që kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të grave dhe që operojnë në territore të ndryshme të vendit).*

Ndihma juridike dytësore (73 avokatë që kanë lidhur kontratë me DNJF për të ofruar shërbimin ligjor të përfaqësimit në gjykatë për të gjitha kategoritë vulnerabël, në kushtet e pamjaftueshmërisë financiare apo subjektet e veçanta të ligjit).

Ndihma juridike ONLINE (një mekanizëm alternativ i ofrimit të shërbimit ligjor falas përgjatë periudhës së pandemisë dhe që vijon të ofrohet edhe aktualisht, si një mënyrë shumë e mirë për të garantuar shërbim në çdo kohë dhe për çdo qytetar).

Forcimi i kapaciteteve / trajnime (e lidhur drejtpërdrejt me cilësinë e shërbimit që ofrohet nga ofruesit e ndihmës parësore dhe dytësore sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017).

Publikime / promovimi i sistemit të ndihmës juridike (në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit sa më të gjerë të publikut mbi kushtet / kriteret e përfitimit, ofruesit e shërbimit, subjektet përfitues etj).

- Kontribut mbi Forumin Virtual Botëror të të Dhënave të **Kombeve të Bashkuara (UNWDF) 2020.**

Komente përsa i përket **Deklaratës të Grupit të Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe Ndërtimin e Kapaciteteve për statistikat për Axhendën e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (HLG-PCCB);**

Përsa i përket masave të ndërmarra për të garantuar shërbimet ligjore falas edhe përgjatë periudhës së pandemisë së krijuar si rrjedhojë e Covid-19, theksojmë se Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, kanë ndërmarrë hapat e nevojshme për të garantuar ofrimin e shërbimeve ligjore falas, si një shërbim drejtpërdrejt i lidhur me qytetarin, përmes

- Platformës jurisdictionline.al – platformë e krijuar për të garantuar shërbimin e ndihmës juridike falas online, në kushtet e Covid-19, kur zyrat e ndihmës juridike nëpër rrethe u mbyllën. Nga kjo platformë përfiton çdo qytetar dhe nuk kërkohet plotësimi kushteve / kriterëve përfituese.
- Është vendosur në dispozicion numri i gjelbër 08001010 –për t’iu ardhur në ndihmë të gjithë qytetarëve të cilët kanë nevojë për informacione apo orientime të ndryshme ligjore.
- Kontribut i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas lidhur me pyetjet shtesë të parashtruara në draft raportin e hartuar nga **Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA) në lidhje me zbatimin e Konventës nga Shqipëria.**

Sekretariati Teknik i Konventës së Këshillit të Evropës për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore ka njoftuar zyrtarisht se, draft raporti i hartuar nga Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA) në lidhje me zbatimin e Konventës nga Shqipëria (raundi i tretë i vlerësimit), u miratua nga GRETA në mbledhjen e 37-të të tij, të mbajtur nga 29 qershori deri më 3 korrik 2020.

Duke marrë parasysh nenin 38, paragrafi 5, të Konventës dhe Rregullores së procedurës për vlerësimin e zbatimit të Konventës, GRETA u kërkon autoriteteve të japin komente për projekt raportin. Në këtë kuadër, DNJF ka dhënë kontributin e saj përsa i përket komponentit të aksesit në drejtësi përmes shërbimeve të ndihmës juridike falas.

- **Kontributi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kuadër të raportimit të pestë për zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.**

Materiali përmban zhvillimet kryesore sa i përket sistemit të ndihmës juridike dhe garantimit të aksesit në drejtësi përmes shërbimeve ligjore falas dhe është strukturuar si vijon:

Informacion i përmbledhur mbi zhvillimet kryesore të vitit 2020 për garantimin e aksesit në drejtësi për personat në pamundësi financiare dhe grupet vulnerabël.

- kuadri ligjor;
- ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore;
- shërbimi online;
- aktivitete në kuadër të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor.

Angazhimet strategjike me fokus masat e shtuara për garantimin e aksesit në drejtësi të kategorive vulnerabël. (*angazhimet strategjike në të cilat Drejtoria është përfshirë janë shumë të rëndësishme sepse kanë në fokus masa të parashikuara drejtpërdrejt për grupet vulnerabël*).

Informacion mbi buxhetin dhe të dhëna statistikore.

3. Kontribut në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit IPA:

- Kontribut në kuadër të IPA II

Kontrata sektoriale “BE për Reformën në Drejtësi”, synon të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës, zbatimit të ligjit dhe të ulë korrupsionin në institucionet qeveritare dhe në gjyqësor. Masat e parashikuara do të kontribuojnë në forcimin e pavarësisë, transparencës, efikasitetit, llogaridhënies dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në Shqipëri në përputhje me standardet evropiane, si edhe do të rrisë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në sistemin (penitenciar) e vuajtjes së dënimit.

IPA II është miratuar nëpërmjet VKM – së nr. 476, datë 10.07.2019 “Miratimin në parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2018, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA II)”. Kontrata Sektoriale “BE për Reformën në drejtësi” pjese e kësaj marrëveshje do të zbatohet për 4 vite, nga data e nënshkrimit: Korrik 2019 - Dhjetor 2022.

Lidhur me treguesit / indikatorët specifikë raportohet mbi arritjet e përfundimit të tyre dhe ne baze të vlerësimit të këtyre arritjeve do të disbursohen edhe shumat buxhetore të përcaktuara në kontratën “BE për reformën në Drejtësi”.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për sa i përket përbushjes së **indikatorit 7 “Free legal aid services are functional”, në zbatim të Kontratës Sektoriale “BE për Reformën në Drejtësi”,** ka përcjellë kontribut si vijon:

- Material përmbledhës mbi ecurinë dhe zhvillimet kryesore të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas përgjatë vitit 2019;
- Material përmbledhës mbi ecurinë dhe zhvillimet kryesore të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas përgjatë vitit 2020;

Gjithashtu, DNJF ka përcjellë shtojcë me të dhëna statistikore për vitin 2019 (ndihma juridike parësore dhe dytësore), në versionin anglisht dhe shqip.

- Kontribut në kuadër të IPA III

Është plotësuar Action Document IPA III, nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Në dokument është plotësuar tabela përkatëse e seksionit 3 duke marrë në konsideratë që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka hartuar tashmë një Strategji për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti dhe Planin e masave të Veprimit (strategjia është pjesë e Strategjisë të madhe Ndërsektoriale të Drejtësisë SND). Në këtë kuadër, duke patur një strategji të dedikuar për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, edhe për plotësimin e dokumentit të veprimit për IPA III i jemi referuar pikërisht strategjisë 5-vjeçare të DNJF.

Aktivitetet kryesore të parashikuara për IPA III, janë si vijon:

- Implementimi i politikave të reja për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.
- Forcimi i kapaciteteve të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.
- Implementimi i Planit të Komunikimit dhe Vizibilitetit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

Kapitulli 12

PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021

Ministria e Drejtësisë dhe DNJF ka planifikuar realizimin e 11 objektivave për vitin 2021, objektiva të cilat synojnë dhe kanë karakter politikbërës, rregullator, menaxhues dhe legjislativ, të strukturuar sipas modeleve më të mira bashkëkohore të shërbimit ndaj qytetarëve, konkretisht:

- Forcimi i Kapaciteteve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas;
- Ngritja e “case management system” në kuadër të administrimit të të dhënave;
- Mirëfunksionimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore;
- Hapja e qendrave të reja të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në bashkëpunim me UNDP;
- Financimi i organizatave jofitimprurëse të autorizuara;
- Ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike dytësore;
- Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes;
- Bashkëpunimi me donatorë dhe institucionet e përfshira në sistemin e ndihmës juridike falas;
- Rritje e angazhimit të DNJF në kuadër të dokumentave strategjike;
- Rritje e angazhimit të DNJF në kuadër të procesit të integritetit evropian;
- Promovimi i sistemit të ndihmës juridike;
- Forcimi i kapaciteteve të stafit të DNJF / ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike;
- Menaxhimi dhe planifikimi financiar i sistemit të ndihmës juridike;
- Krijimi i një Komiteti Ndërinstitucional për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

Kapitulli 13

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA²⁷

Gjatw vitit 2020 është kryer vetëm *një hetim administrativ* nga Avokati i Popullit lidhur me miratimin e akteve nënligjore dhe ngritjen e strukturave të reja. Në përfundim të këtij hetimi, **me shkresën nr. K2/E31-4, Prot., datë 26.06.2020**, protokolluar pranë nesh me nr. 295 Prot, datë 29.07.2020, na janë përcjellë disa rekomandime konkretisht si vijon:


1. *Marrja e masave për plotesimin e organikes se drejtorise;*
2. *Marrja e masave për miratimin e te gjithë paketes se akteve nenligjor ne fushen e ndihmes juridike te garantuar nga shteti;*
3. *Marrja e masave për krijimin e qendrave te sherbimit te ndihmes juridike paresore.*
4. *Marrja e masave për realizimin e fushatave informuese për qytetaret;*
5. *Marrja e masave për autorizimin e organizatave jofitimprurese te autorizuar qe ofrojne ndihme juridike te garantuar nga shteti;*
6. *Marrja e masave për shtimin e Klinikave te Ligjit me te cilat Drejtoria ka lidhur marreveshje bashkepunimi;*
7. *Marrja e masave për nje konsultim me te gjere ne te ardhmen lidhur me prioritetet e ndihmes juridike falas.*

Lidhur me këto rekomandime, DNJF ka ndërmarrë të gjitha masat me qëllim përmbushjen e tyre duke marrë në konsideratë që këto rekomandime janë njëkohësisht edhe objektiva në Planin e Punës të DNJF për vitin 2020²⁸. Sa i përket ecurisë dhe zhvillimeve që DNJF ka patur specifikisht për secilën nga këto rekomandime, shpjegohen në kapituj e sipërcituar.

²⁷ Përgjatë vitit 2020, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka patur disa korrespondenca me institucione të pavarura, konkretisht si vijon: **Shkresa me nr. K1/I147-7 Prot, datë 30.10.2020**, nga Avokati i Popullit, mbi realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016 – 2020. Nga ana e DNJF është kthyer përgjigje me shkresën me nr. 536/1 Prot. Datë 17.11.2020. **Shkresa me nr. K2/F16-2 Prot., datë 11.11.2020**, nga Avokati i Popullit, me lëndë: Kërkesë për informacion për ankesën e shtetasit Fildiz Hoxha. Nga ana e DNJF është kthyer përgjigje me shkresën me nr. 549/1, Prot., datë 17.11.2020. **Shkresa me nr. 393 Prot, datë 30.09.2020**, drejtuar Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me lëndë: kërkesë për afishimin e posterave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. **Shkresa me nr. 332 Prot., datë 18.08.2020**, drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me lëndë: kërkesë për orientim mbi publikimin e regjistrat të kërkësve dhe vetëdeklarimeve. **Shkresa me nr. 4868/1 Prot., datë 13.10.2020**, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në kuadër të lidhjes së marrëveshjes së mirëkuptimit me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike falas sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017”. **Shkresa me nr. 4638/2 Prot., datë 05.10.2020**, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me lëndë: Mbi shkresën e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për garantim të mbrojtjes, dhënie ndihme juridike dytësore. Nga ana e DNJF është kthyer përgjigje me shkresën nr. 363/5 Prot., datë 08.10.2020.

²⁸ **Sa i përket plotesimit të organikes se Drejtorise**, "Drejtori i Pergjithshem (TND) është emruar me urdhërin nr. 201, datë 1.7.2020 të Ministrisë të Drejtësisë. Për tre drejtorët e drejtorive të ndihmës juridike, janë shpallur në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, vendet vakante të mbetura; Është shpallur kandidati fitues në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Paresore ne muajin Nentor 2020. Për 2 vendet e tjera DNJF ka proceduar me kerkese prane Dap per rishpalljen e tyre. **Paketa e akteve nenligjore** eshte miratuar ne masen 100% (2 aktet me te fundit nenligjore te cilat lidhen me miratimin e tarifave te shperblimit te avokateve te ndihmes juridike dytesore dhe caktimin e tyre mbi bazen e parimit te rotacionit jane miratuar ne Shtator 2020). **DNJF pergjate kesaj periudhe ka zhvilluar fushata te ndryshme ndergjegjesimi** ne qytete te ndryshme te Republikes se Shqiperise gjate te cilave jane afishuar stenda dhe shperndare fletpalosje dhe postera, duke orientuar qytetaret mbi sistemin e ndihmes juridike te garantuar nga shteti (Fushata ne Tirane, Lezhe dhe Fier si dhe zhvillimi i intervistave televizive). **Ne muajin Shtator 2020 ka perfunduar procesi i autorizimit** te organizatave jofitimprurese te autorizuar per ofrimin e ndihmes juridike te garantuar nga shteti. Konkretisht, me urdher te Ministrise te Drejtësisë jane autorizuar 12 OJF qe operojne ne Tirane, Durres, Berat, Shkoder dhe Elbasan. Aktualisht DNJF ka lidhur **marreveshje bashkepunimi me 9 Klinika Ligjore** prane Institucioneve te arsimit te larte dhe konkretisht: Klinika e Ligjit prane Fakultetit te Drejtësisë; Koegjit universitar Wisdom; Universitetit

Aleksander Mojsiu Durres; Universitetit Ismail Qemali Vlore; UET; Kolegjit Universitar Beder; Kolegjit Universitar "Qirjazi"; Klinikën e Ligjit Shkoder si dhe Universitetin Mesdhetar te Tiranës. **Sa i perket rekomandimit nr. 7 bejme me dije se DNJF eshte ne proces te hartimit te nje strategjie per ndihmen juridike te garantuar nga shteti** dhe planit te saj te veprimit ku nje nder masat eshte krijimi i nje Komiteti me sekretariat teknik prane DNJF dhe me aktore te ndryshem perfaqesues, i cili periodikisht do te diskutoje sa i perket prioriteteve te ndihmes juridike falas dhe masave qe duhet te ndermarre. Gjithashtu DNJF eshte pjese edhe e Strategjise Ndersektoriale te Drejtesise referuar te ciles zhvillohen ne menyre periodike takime teknike ku perfaqesues te ndryshem kane mundesine te diskutojne dhe te propozojne masa qe duhet te ndermerren ne kuader te forcimit te sistemit te ndihmes juridike te garantuar nga shteti. Nje nga anagazhimet e DNJF i cili lidhet direkt me konsultimin e gjere sa i perket prioriteteve dhe me transparencen eshte perfshirja e Drejtorise ne Planin per Partneritet dhe Qeverisje te Hapur (OGP), ne te cilin DNJF ka percaktuar prioritetet dhe objektivat te cilat jane te pasqyruara dhe ne faqen e OGP krijuar per kete qellim. ne kete kuader, DNJF ka qene pjese e te gjitha takimeve teknike / konsultative te zhvilluara mbi OGP, me pjesemarrjen e te gjitha institucioneve te perfshira dhe shoqerise civile.

SHTOJCË NR.1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

RAPORT

**MBI MONITORIMIN E QENDRAVE TË SHËRBIMIT
TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE**

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje.....

KREU I: METODOLOGJIA E VLERËSIMIT SI DHE BAZA LIGJORE

- Fusha e vlerësimit dhe Indikatorët kryesorë të vlerësimit të Ndhmës Juridike Parësore.....
- Koordinimi dhe Mbikëqyrja e Ndhmës Juridike Parësore.....

KREU II: MONITORIMET E KRYERA NGA DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE

2.1: Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në **Tiranë**.....

- Monitorimi tre mujor i kryer më datë 13.08.2020.....
- Monitorimi tre mujor i kryer më datë 22.12.2020
- Analizë e Raporteve mujore narrative.....

2.2: Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në **Durrës**.....

- Monitorimi tre mujor i kryer më datë 15.07.2020.....
- Analizë e Raporteve mujore narrative.....

2.3: Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në **Fier**.....

- Monitorimi tre mujor i kryer më datë 23.07.2020.....
- Analizë e Raporteve mujore narrative.....

2.4: Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në **Lezhë**.....

- Monitorimi tre mujor i kryer më datë 11.08.2020.....
- Analizë e Raporteve mujore narrative.....

2.5: Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në **Pogradec**.....

- Monitorimi i kryer më datë 30.12.2020.....
- Analizë e Raporteve mujore narrative.....

2.6: Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në **Lushnje**.....

- Monitorimi i kryer më datë 04.12.2020.....
- Analizë e Raporteve mujore narrative.....

2.7: Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në **Gjirokastrë**.....

- Analizë e Raporteve mujore narrative.....

2.8: Monitorimi i Qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në **Shkodër**.....

- Analizë e Raporteve mujore narrative.....

KREU III: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Hyrje

Një komponent shumë i rëndësishëm i ofrimit të ndihmës juridike falas është cilësia e këtij shërbimi. Shërbimi i ndihmës juridike falas quhet së është garantuar në mënyrë të plotë, me eficiencë dhe efektivitet vetëm atëherë kur është ofruar me cilësinë e duhur. Në këtë kuadër, është shumë e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendja e duhur kombinimit të shifrave sasiore me të dhënat e cilësisë së shërbimit. Kombinimi i të dhënave statistikore me cilësinë që ka prodhuar këto të dhëna janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën, si pjesë e një pakete unike shërbimi dedikuar qytetarit.

Referuar nenit 8 të **Ligjit nr.111/2017**, (pika I dh II), Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas zbaton sistemin e vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike dhe mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët.

Në zbatim të këtyre parashikimeve, me Urdhrin nr. 534, datë 25.11.2019, “*Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike*”, është miratuar metodologjia që do të ndiqet për të vlerësuar dhe mbikëqyrur cilësinë e shërbimeve të ofruara të ndihmës juridike.

Ky dokument shpjegon nocionin e ndihmës juridike, referuar ndihmës juridike parësore dhe dytësore, shërbimet që përfshin secila ndarje, qëllimet që ndjek ndihma juridike referuar ligjit 111/2017, metodologjinë e vlerësimit dhe procedurat e mbikëqyrjes dhe koordinimit.

KREU I: METODOLOGJIA E VLERËSIMIT SI DHE BAZA LIGJORE

Qëllimet e ndihmës juridike falas janë udhëzuesi i mënyrës së ushtrimit të kësaj veprimtarie. Më konkretisht veprimtaria e ndihmës juridike falas, duhet të ushtrohet në mënyrë të tillë që të krijojë akses në drejtësi edhe për qytetarët me vështirësi ekonomike, duhet të jetë e mirëorganizuar, e mirëadministruar dhe funksionale; dhe duhet të garantojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike të cilat të jenë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Metodologjia e përdorur për ushtrimin e kontrollit është e përcaktuar në Urdhrin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë në të cilin janë përcaktuar disa indikatorë mbi bazën e të cilëve do të kryhet vlerësimi.

- *Fusha e vlerësimit dhe Indikatorët kryesorë të vlerësimit të Ndhmës Juridike Parësore*

Shtylla 1 – Sturktura Organizative

A. Fusha e vlerësimit: Përshtatshmëria e ambjenteve të punës.

Indikatorët kryesorë: Qendra Pritëse; Zyra të brendshme; Arkivi; Mjetet e punës; Aksesueshmëria e zyrës.

1. Ambientet e Përshtashme: Ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore ka së pari nevojë për ambjente të përshtatshme ku të kryhen të gjitha veprimtaritë e dhënies së ndihmës juridike me të njejtat standarte që do të zbatoheshin pranë çdo zyre private që ofron shërbime ligjore për klientët e saj.

2. Zyra Pritëse: Referuar metodologjisë, Qendra e Ndhmës Juridike Parësore duhet të jetë e pajisur me një zyrë pritëse që të kryejë funksione të komunikimit të parë me klientët dhe regjistrimit të tyre. Staf i zyrës pritëse duhet të përbëhet nga juristë të cilët kryejnë funksionin e pritjes së parë të klientit: ndihmojnë klientin në plotësimin e formularëve të vetëdeklarimit; japin konsulta juridike ose hartojnë kërkesa të thjeshta kur çështja nuk ka nevojë për shqyrtim të thelluar nga avokatët; regjistrojnë çështjet e klientëve dhe përcjellin tek avokatët çështjet që kanë nevojë për shqyrtim më të thelluar.

3. Zyra të brendshme: Sipas metodologjisë, qendrat e ndihmës parësore duhet të kenë në dispozicion zyra të brendshme ku të presin klientët e tyre dhe të sigurojnë kushtet e konfidencialitetit në lidhje me çështjet e tyre.

4. Arkivi: Zyra e ndihmës juridike parësore duhet të ketë në dispozicion një arkiv fizik dhe/ose elektronik për ruajtjen e dosjeve dhe dokumentave në format shkresor të klientëve. Çdo jurist duhet të kujdeset për arkivimin e dokumentacionit sipas rregullave dhe standardeve të profesionit ligjor duke u kujdesur veçanërisht për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetit. Mbajtja e sistemit të arkivimit elektronik krahas atij fizik përbën një përparësi duke bërë që kjo IKV të vlerësohet me 1 pikë.

5. Mjetet e punës: Qendra e ndihmës juridike parësore duhet të ketë ambient të pajisur me mjetet minimale të punës të tilla si mjete elektronike, kancelari, librarinë ligjore fizike të përbërë nga kodet e përditësuara, përmbledhje të legjislacionit, manual ligjore, përmbledhje të praktikës gjyqësore etj.

6. Aksesueshmëria e ambienteve: Aksesueshmëria e ambienteve është një tjetër indikator për vlerësimin e shërbimit të ndihmës juridike. Ambientet e Qendrës së ndihmës juridike parësore

duhet të jenë të aksesueshme nga persona me aftësi të kufizuar ose nga të moshuarit dhe duhet të kenë kushtet minimale për pritjen dhe akomodimin e tyre.

B. Fusha e vlerësimit: Përshtatshmëria Procesit të Punës

Indikatorët kryesorë: Përcaktimi dhe ndarja e qartë e funksioneve; Procesi i pritjes dhe trajtimit të Klientëve; Rregullorja e Procesit të Punës.

1. Përcaktimi dhe ndarja e qartë e funksioneve: Sipas këtij indikator, kriteri kryesor i vlerësimit është që Avokatët dhe juristët të kenë kompetenca të qarta dhe tërësisht të ndara. Avokati nuk mund të ushtrojë funksionet e juristit dhe juristi nuk mund të ushtrojë funksionet e avokatit.

2. Procesi i pritjes dhe trajtimit të Klientëve: Sipas metodologjisë, procedura e pritjes dhe trajtimit të rastit të klientit është thelbësore dhe duhet të jetë e mirëpërcaktuar. Duhet mbajtur parasysh se klientët e Qendrës së ndihmës juridike falas shpeshherë janë në situatë të vështirë psikologjike për shkak të vështirësive ekonomike dhe kohëzgjatjes së problemit ligjor për të cilin kërkojnë ndihmë juridike. Për këtë arsye, gjatë trajtimit të rastit në Qendrën e ndihmës juridike parësore duhet shmangur që klienti të përcillet nga njëri avokat në tjetrin përveç rasteve të urgjencës kur kjo është e domosdoshme. Gjithashtu juristi pritës, pas kryerjes së trajtimit fillestar nëpërmjet regjistrimit, plotësimit të formularëve dhe pyetjeve në lidhje me çështjen, duhet ta adresojë klientin tek një nga avokatët e ndihmës juridike në rast se konsulenca ligjore është jashtë kompetencave të juristit. Do të trajtohen me përparësi rastet që kanë të bëjnë me skadencë afatesh, ndërsa rastet e tjera do t'i nënshtrohen listës së pritjes në varësi të çështjeve pararendëse.

3. Rregullorja e Procesit të Punës: Sipas metodologjisë për të mundësuar që procesi i punës të rrjedhë rregullisht dhe të zbatohen kushtet minimale të përcaktuara më sipër, Qendra e Ndihmës Juridike parësore duhet të veprojë bazuar në Rregulloren e procesit të punës, ku të përcaktohen detyrat e stafit, rregullat kryesore të procesit të punës, si dhe mbikqyrësi i procesit të punës. Kjo rregullore duhet të jetë e njohur nga i gjithë stafi i ndihmës juridike parësore të cilët mund t'i nënshtrohen edhe trajnimeve specifike në lidhje me të, nëse kjo rezulton e nevojshme.

Shtylla II: Burimet njerëzore

A. Fusha e vlerësimit: Përshtatshmëria e Kapaciteteve Profesionale

Indikatorët kryesorë: Arsimi; Kualifikimi profesional; Trajnimi.

1. Arsimi: Sipas metodologjisë, Avokatët dhe juristët të cilët kanë vazhduar të arsimohen përtej arsimit të detyrueshëm konsiderohen si vlerë e shtuar në sistemin e ndihmës juridike falas. Nëse i referohemi tabelës së IKV-ve vlerësohen me (4) stafi në process të mbylljes së arsimit të detyrueshëm dhe me (5) stafi pa arsim të detyrueshëm.

2. Kualifikimi profesional: Kualifikimi profesional është thelbësor për garantimin e cilësisë së ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Kualifikimi profesional i kërkuar për juristët dhe avokatët duhet të jetë i ndryshëm dhe të reflektojë përgjegjësitë dhe kompetencat e secilës kategori. Megjithatë në procesin e rekrutimit duhet të kenë përparësi avokatët dhe juristës me njohuri në të drejtën civile, të drejtën, administrative, të drejtën penale, të drejtën familjare, të drejtat e njeriut, proceset gjyqësore, dhe njohuri në fushat specifike më të hasura në sistemin e ndihmës juridike falas. Eksperienca e gjatë profesionale dhe shumëllojshmëria e fushave të mbuluara nga avokatët apo juristës përbën një vlerë të shtuar.

3. Trajnimi: Trajnimi i profesionistëve të ndihmës juridike falas është një element thelbësor si për ndihmën juridike parësore ashtu edhe për ndihmën juridike dytësore. Avokatët dhe juristës e ndihmës juridike parësore duhet të marrin trajnimet e posaçme për ofrimin e ndihmës juridike parësore. Gjithashtu Avokatët e ndihmës juridike dytësore duhet të kenë trajnimet e posaçme për fushat e veprimtarisë të mbuluara prej tyre si p.sh proceset me të mitur viktime ose dëshmitarë, raste të dhunës në familje etj. Në procesin e vlerësimit, avokatët dhe juristët me trajnim të posaçëm në ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, të marrë brenda apo jashtë vendit, duhet të konsiderohen vlerë e shtuar. Trajnimet në lidhje me fusha sensitive të tilla si dhuna në familje, mbrojtja e fëmijëve, trajtimi i personave me aftësi të kufizuara etj. kanë peshë në procesin e vlerësimit.

B. Fusha e vlerësimit: Respektimi i Kodit të Etikës Profesionale.

Indikatorët kryesorë: Pavarësia; Ruajtja e konfidencialitetit; Shmangia e konfliktit të interesit; Trajtimi me dinjitet i klientit; Kthimi i dokumentave.

1. Pavarësia: Juristi është i pavarur në ushtrimin e profesionit të tij. Për të siguruar pavarësinë avokati duhet të jetë i lirë nga çdo ndikim që mund të lindë nga interesat e tij personale ose nga presioni i jashtëm. Dhe duhet të shmangë çdo cënim të pavarësisë së tij dhe të mos kompromentojë standartet profesionale për të kënaqur klientin, apo të tretët

2. Ruajtja e konfidencialitetit : Juristi duhet të ruajnë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të dhënë nga klienti gjatë kryerjes së shërbimeve për klientin bazuar në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit (ref. ligji 111/2017).

3. Shmangia e konfliktit të interesit: Juristët e sistemi të ndihmës juridike falas duhet të lidhin një marrëdhënie besimi me klientin. Besimi arrihet kur avokati dhe juristi e trajtojnë klientin me ndershmeri, integritet dhe dinjitet.

4. Kthimi i dokumentave: Me kërkesën e klientit avokati dhe juristi i ndihmës juridike falas duhet t'i kthejë klientit çdo dokument origjinal të marrë dorëzuar nga Klienti. Marrja dhe kthimi i

dokumentave origjinale do të bëhet me një procesverbal të nënshkruar nga Avokati dhe/ose juristi dhe Klienti në fjalë.

C. Fusha e vlerësimit: Përshtatshmëria e Cilësisë së Shërbimit.

Indikatorët kryesorë: Analizë e thelluar; Cilësia e dokumentave të hartuara; Koha e shqyrtimit; Numri i rasteve të shqyrtuara.

1. Analizë e thelluar: Profesionistët e ndihmës juridike falas parësore dhe dytësore duhet të kryejë analizën e thelluar të çështjeve ligjore për të cilat klientët kërkojnë ndihmë juridike. Analiza e thelluar konsiston në kuptimin e qartë të problemit ligjor, verifikimin e dokumentacionit të sjellë nga klientët, udhëzimin për sjelljen e dokumentacionit shtesë në rast se ka mangësi në kuptimin e plotë të çështjes. Analiza e thelluar vlen veçanërisht për avokatët e ndihmës juridike parësore dhe avokatët e ndihmës juridike dytësore të cilët kanë kompetencë të trajtojnë çështjen me anë të hartimit të dokumentave ligjore në mbrotje të interesave të klientit dhe përfaqësimit gjyqësor. Ky parim vlen edhe për juristët e Qendrës së ndihmës juridike parësore të cilët duhet të kuptojnë thelbin e çështjes përpara dhënies së konsulencës, apo hartimit të kërkesave dhe ankesave.

2. Cilësia e dokumentave të hartuara. Profesionistët e ndihmës juridike falas, Avokatët dhe juristët, gjatë punës së tyre hartojnë kërkesa, ankesa, ankime administrative, kërkesë padi, rekurse dhe dokumenta të ngjashme ligjore sipas nevojës së mbrojtjes së interesave të klientit. Cilësia e dokumentave të hartuara do të vlerësohet nga qartësia e shpjegimit të çështjes, cilësia e argumenteve ligjore, legjislacioni mbështetës i shqyrtuar, referenca ndaj parimeve ligjore kryesore të tilla si parimet e të drejtës civile, administrative, kushtetuese, penale etj., referenca ndaj legjislacionit të fushës përkatëse.

3. Koha e shqyrtimit: Në kuadër të parimit të efikasitetit dhe efektivitetit, avokatët dhe juristët e zyrës së ndihmës ligjore parësore duhet të shqyrtojnë çështjen brenda kohës më të shkurtër të mundshme. Koha e shqyrtimit nuk është e paracaktuar dhe ajo është ngushtësisht e lidhur me kompleksitetin e çështjes në shqyrtim, sasinë e dokumentacionit të shqyrtuar si dhe ngarkesën e punës të stafit me çështje pararendëse. Të gjitha këto elemente do të merren në konsideratë në vlerësimin e kohës së shqyrtimit. Do të trajtohen me përparësi çështjet të cilat kanë afate skandence.

4. Numri i rasteve të shqyrtuara: Në kuadër të parimit të efikasitetit dhe efektivitetit, avokatët dhe juristët e zyrës së ndihmës ligjore parësore duhet të shqyrtojnë në mënyrë të thelluar sa më shumë çështje. Numri i çështjeve të shqyrtuara nuk mund të paracaktohet dhe është ngushtësisht e lidhur me numrin e klientëve, numrin e çështjeve në proces, kohën në dispozicion të stafit për të trajtuar çështjet dhe rrethana të tjera objektive. Të gjitha këto elemente do të merren në konsideratë në vlerësimin e numrit të rasteve të shqyrtuara dhe do të përbëjnë një IKV të rëndësishme për planifikimet e ardhshme të burimeve njerëzore dhe financiare dedikuar ndihmës juridike parësore.

- ***Koordinimi dhe Mbikëqyrja e Ndhmës Juridike Parësore***

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas nëpërmjet strukturës përgjegjëse të saj ushtron funksione mbikqyrëse dhe koordinuese mbi Qëndrat e ndhmës juridike parësore.

Funksionet Koordinuese

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e Qëndrave të ndhmës juridike parësore kujdeset për mbarëvajtjen e procesit të punës. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen cakton pikat e kontaktit me qendra e shërbimit të ndhmës juridike parësore në lidhje me çdo aspekt të veprimtarisë së tyre duke trajtuar të gjitha çështjet e administrimit të zakonshëm.

Funksionet Mbikëqyrëse

Mbikqyrja e standarteve të ofrimit të ndhmës juridike parësore do të kryhet nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen pranë DNJF. Mbikqyrja përkon me aktivitetet e mëposhtëme:

Monitorimi fillestar

kjo strukturë do të monitorojë Qendrën e ndhmës juridike parësore në momentin e ngritjes së saj për të vlerësuar nëse i përmbush standartet minimale të përshtatshmërisë së ambienteve sipas IKV-ve përkatëse. Personi përgjegjës i Qendrës së ndhmës juridike parësore do të mbajë një procesverbal në lidhje me gjendjen e ambienteve të cilin do ta përcjellë pranë DNJF-së.

Monitorime tre mujore

Çdo tre muaj, Struktura përgjegjëse e ndhmës juridike parësore, do të kryejë monitorime një ditore për të vlerësuar zhvillimin e punës pranë Qendrës të ndhmës juridike parësore nën përgjegjësinë e tij/saj. Gjatë këtyre monitorimeve do të vlerësohet zhvillimi i procesit të punës, respektimi i kodit të etikës, rregullat e pritjes së klientëve dhe të arkivimit të dokumentave. Gjatë procesit të monitorimit mbikqyrësi mund gjithashtu të kryejë bashkëbisedime/intervista me klientët e pranishëm në Qendrën e ndhmës juridike parësore. Në fund të ditës së monitorimit, mbikqyrësi përgatit një raport në lidhje me monitorimin.

Monitorimi i vazhdueshëm

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen ka akses në të gjitha dokumentat në format elektronik apo dhe në format shkresore, të hartuara nga avokatët dhe juristët e Qendrës së ndhmës juridike parësore të cilat mund t'i monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të kërkojnë sqarimet përkatëse nga avokatë dhe juristët.

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen mbledh dhe shqyrton raportet mujore dhe skedat e klientit të hartuar nga avokatët dhe juristët e ndhmës juridike parësore. Gjithashtu ka të drejtën të trajtojë në çdo kohë ankesat e klientëve kundrejt avokatëve apo juristëve dhe të organizojë takime me këta të fundit në lidhje me çështjen në fjalë.

Vlerësimi i performancës së Juristëve

Bazuar në monitorimet e kryera, raporte mujore dhe skedat e klientit të dërguara nga Avokatët dhe Juristët e ndihmës juridike parësore, struktura përgjegjëse kryen vlerësimin e performancës së këtyre të fundit. Vlerësimi i performancës do të kryhet duke përdorur IKV-të e vlerësimit të përcaktuara për Shtyllën II – burimet njerëzore dhe mjetet e vlerësimit të përcaktuara më lart në këtë dokument.

Vlerësimi i performancës do të kryhet 1 herë në vit, në fund të vitit të punës, në mënyrë individuale për secilin jurist apo avokat të angazhuar pranë Qendrës së ndihmës juridike parësore. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen do të hartojë raportin paraprak të vlerësimit, të cilin do t’ja dërgojë për dijeni juristit apo avokatit përkatës duke caktuar edhe një datë për takimin dhe diskutimin e raportit.

Raporti përfundimtar i vlerësimit të performancës do të hartohet pas takimit dhedo të përmbajë vlerësimin dhe rekomandimet nga mbikëqyrja dhe monitorimi si dhe komentet dhe rekomandimet e juristit apo avokatit të vlerësuar. Raporti i vlerësimit të performancës do të hartohet sipas formatit të Aneksit 3 bashkëlidhur.

KREU II: MONITORIMET E KRYERA NGA DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE

2.1: MONITORIMI I QENDRËS SË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE NË TIRANË

Monitorimi tre mujor i kryer më datë 13.08.2020:

Në zbatim të Urdhrit nr. 245 prot., datë 14.07.2020 “Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e cilësisë së shërbimeve të ofruesve të ndihmës juridike parësore”, grupi i punës me përfaqësues të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike, **me datë 13.08.2020 ka ushtruar kontroll në Qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Tiranë.**

Kontrolli nga grupi i mbikëqyrjes u krye me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës, rregullat e pritjes së qytetarëve dhe arkivimit të dokumentave, cilësisë së shërbimit të ofruar, sipas parashikimeve të përcaktuara në **Urdhrin nr. 531, datë 25.11.2019**, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike.

Ky kontroll u ushtrua duke patur në fokus mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofrimit të këtij shërbimi të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunktionimit, profesionalizmit, cilësisë, eficiencës dhe efektivitetit.

Nga monitorimi i kësaj qendre u konstatua së shërbimi është ofruar në mënyrë eficiente dhe vihet re një numër i konsiderueshëm rastesh të trajtuara.

Disa problematika të konstatuara gjatë këtij monitorimi, **konkretisht:**

- *Mosadminstrimi i formularëve për ofrimin e ndihmës juridike parësore*, miratuar me Urdhër nr.225, datë 25.03.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.
- Mosmbajtja e **proces-verbalit** të kërkuar nga ligji 111/2017;
- *Moszbatimi i plotë i detyrimeve që rrjedhin nga metodologjia e vlerësimit* të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike, e miratuar me Urdhër nr. 531 datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë (mosplotësimi i skedës së klientit, protokollin për pritjen dhe trajtimin e klientit).

Në fund të monitorimit, nga ana e Drejtorisë së Mbikëqyrjes është hartuar një **raport përmbledhës** i cili ju është përcjellë punonjësve të qendrës, OSFA-s dhe Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë raport janë pasqyruar të gjitha gjetjet dhe konstatimet dhe janë përcjellë rekomandime bazuar mbi problematikat e konstatuara. Gjithashtu, raportit i janë bashkëlidhur anekset e plotësuara me vlerësimin sipas sistemit të pikëzimit, referuar metodologjisë së miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Monitorimi tre mujor i kryer më datë 22.12.2020:

Në zbatim të Urdhërit nr. 659 Prot. datë 21.12.2020“*Për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Cilësisë së Qendrës së Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë*”, grupi i punës me përfaqësues të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike, me datë 22.12.2020 ka ushtruar kontroll në Qendrën e Ndihmës Juridike Parësore Tiranë.

Kontrolli nga grupi i mbikëqyrjes u krye me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë Qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës, rregullat e pritjes së qytetarëve dhe të arkivimit të dokumentave, cilësisë së shërbimit të ofruar, sipas parashikimeve të përcaktuara në Urdhër nr.531, datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Ky kontroll u ushtrua duke pasur në fokus, mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofrimit të këtij shërbimi, të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunktionimit, profesionalizmit, cilësisë dhe efektivitetit.

Metodologjia e përdorur për ushtrimin e kontrollit ishte leximi i akteve dhe tërheqja fizike e tyre, për qëllime dokumentimi. Në vijim, materiali i grumbulluar sipas çështjeve të kontrolluara iu nënshtrua analizës dhe ballafaqimit të tij me kërkesat e legjislacionit përkatës referuar si më lart.

Në përfundim, grupi i punës mbajti raportin sipas formatit standart bashkëlidhur “Metodologjisë dhe Procedurave të Mbikëqyrjes”; Aneksi 5 “Raporti i Vlerësimit të Strukturës Organizative për Ndhmën Juridike Parësore”; Raportimet për kërkesat e trajtuara në formatin excel; si dhe raporti mbi mbikëqyrjen e kontrollit të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore ofruar nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë.

Nga monitorimi **ka rezultuar** se:

Janë raportuar 165 raste të trajtuara nga qendra, për muajt Shtator, Tetor dhe Nëntor.

- **Nuk është mbajtur skeda e klientit të ndihmës juridike parësore**, aneksi 1, detyrim ligjor që rrjedh nga Urdhër Nr. 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.
- **Nuk janë mbajtur dhe plotësuar formularët për ndihmën juridike parësore**, sikurse është e përcaktuar në ligj (*sipas akteve nënligjore të miratuara nga Ministri i Drejtësisë*).
- Për rastet e raportuara nga qendra **mungon dokumentacioni provues** që kërkuar i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar.
- Evidentojmë se **nuk janë mbajtur dosje të ndara për çdo rast** të trajtuar (për çdo qytetar që ka përfituar ndihmë juridike parësore).
- Për rastet e trajtuara mungon proces-verbali sipas parashikimeve të nenit 17, pika 7 të ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- Rezulton se nuk ka një protokoll të formalizuar për procesin e pritjes dhe trajtimit të klientit.

Bazuar në problematikat e konstatuara mësipër dhe mungesën e dokumentacionit qoftë të pritjes së klientit, po ashtu dhe atij provues që kërkuar i është ofruar zgjidhja e problematikës së parashtruar, grupi i punës ndodhet në kushtet e pamundësisë për të vlerësuar cilësinë e shërbimit të ofruar nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë për periudhën Shtator – Nëntor 2020.

Rekomandime:

- Të vijohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore me efikasitet të plotë duke trajtuar çdo rast sipas specifikave konkrete.

- Të vijohet me promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe orientimin sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore.
- Për cdo rast të trajtuar të mbahet *dokumentacioni provues* (shkresor ose në çdo formë tjetër të kërkuar nga ligji) për zgjidhjen e rastit dhe të mbahet *formulari për trajtim kërkesash për ndihmë juridike* parësore sipas formatit të miratuar me Urdhër Nr. 225, datë 25.03.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.
- Të mbahet *protokoll i mirëfilltë për pritjen dhe trajtimin e klienteve*.
- Në vijim, për çdo qytetar që përfiton ndihmë juridike të mbahet *dosje më vete*.
- Për cdo rast të trajtuar gjatë ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore të mbahet *proces-verbali* sipas parashikimeve të nenit 17, pika 7 të ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Analizë e Raporteve mujore narrative:

Nga korrespondenca me email rezulton se nga qendra në Tiranë janë përcjellë raportet narrative për muajt respektivë të monitorimit por janë të ndara për çdo punonjës të qendrës. Duke qenë se nuk ka një raport mujor narrativ të vetëm për qendrën, në vijim parashtrohet një analizë e rasteve të trajtuara për të gjithë periudhën, konkretisht:

✚ Raportet mujore Janar – Nëntor 2020

Raportet Mujore Narrative Janar – Nëntor 2020	
Lloji i çështjes	Numri i rasteve të trajtuara
TOTALI = 568 raste	

Nga analizimi i këtyre raporteve rezulton se nga ana e punonjëve të qendrës është ofruar këshillim dhe orientim ligjor për problematikat e referuara nga qytetarët. Sa i përket zgjidhjes së çështjes, në raport është pasqyruar në mënyrë shumë të përmbledhur duke shprehur llojin / natyrën e problematikës dhe orientimin e dhënë nga punonjësit në mënyrë të përgjithshme. Raporti mujor përmban dhe një rubrikë “problematika / sugjerime”, nga ana e punonjësve te qendrës, rubrikë e cila synon përcjelljen e problematikave e vështirësive që mund të hasin në praktikë si dhe sugjerime konkrete që mund të kenë në këtë kuadër. Nga raportet e dërguara nga punonjësit e qendrës rezulton se kjo rubrikë nuk është plotësuar.

✚ Raporti Mujor Narrativ Dhjetor 2020

Raporti Mujor Narrativ	
Lloji i çështjes	Numri i rasteve të trajtuara
Çështje familjare	-
Çështje administrative	4
Çështje civile	22
çështje penale	1
Plotësim dokumentacioni / ndihmë dytësore	11
Informacion mbi ndihmën juridike / ligjin nr.111/2017	10
TOTALI = 48 raste	

2.2: MONITORIMI I QENDRËS SË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE NË DURRËS

Monitorimi tre mujor i kryer më datë 15.07.2020:

Në zbatim të Urdhrit nr. 245 prot., datë 14.07.2020 “Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e cilësisë së shërbimeve të ofruesve të ndihmës juridike parësore”, grupi i punës me përfaqësues të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike, **me datë 11.08.2020 ka ushtruar kontroll në Qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Durrës.**

Kontrolli nga grupi i mbikëqyrjes u krye me qëllim vlerësimin e procesit të veprimtarisë së kryer nga punonjësit pranë qendrës, duke përfshirë respektimin e dispozitave të Kodit të Etikës , rregullat e pritjes së qytetarëve dhe arkivimit të dokumentave, cilësisë së shërbimit të ofruar, sipas parashikimeve të përcaktuara në **Urdhrin nr. 531, datë 25.11.2019**, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike.

Ky kontroll u ushtrua duke patur në fokus mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe nëse përmbushen qëllimet e përgjithshme të ofrimit të këtij shërbimi të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunktionimit, profesionalizmit, cilësisë, eficiencës dhe efektivitetit.

Disa problematika të konstatuara gjatë këtij monitorimi, **konkretisht:**

- **Ofrimi i ndihmës juridike dytësore** dhe përfaqësimi i çështjeve në gjykatë në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 111/2017;
